



safejournalists.net

# MAQEDONIA E VERIUT

## Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në vitin 2022





**MAQEDONIA E VERIUT**  
**Treguesit e nivelit të**  
**lirisë së mediave dhe**  
**sigurisë së gazetarëve**  
**në vitin 2022**

**Authors**  
**Milan Spirovski**  
**Verçe Todorovska-Kostovska**

## Titulli

Maqedonia e Veriut: Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në vitin 2022

## Botues

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë  
Skopje 2023



ЗДРУЖЕНИЕ  
НА НОВИНАРИТЕ  
НА МАКЕДОНИЈА

## Autorë

Millan Spirovski dhe Verçe Todorovska-Kostovska

## Përkthyes

Leunora Kaliqi

## Recensente

Marina Tuneva

## Cover photo

Andrija Vukelić

## Dizajni

comma.rs

## Copies

50

Ky publikim është përpiluar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e vetëm Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë dhe autorëve dhe nuk i pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e bashkimit Evropian.



<b>Hyrje</b>	<b>7</b>	B3 Pavarësia redaktuese në radiodifuzerin publik	21
		B4 Pavarësia redaktoriale në sektorin jofitimprurës	22
<b>A Mbrojtja ligjore</b>	<b>9</b>	B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	22
A1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe gazetarëve dhe zbatimin e tyre në praktikë	9	B6 Pozita ekonomike e gazetarëve	23
A2 Efekti i ligjeve për shpifje ndaj gazetarëve	13	<b>C Siguria e gazetarëve</b>	<b>25</b>
A3 Mbrojtja e pluralizmit politik në media	14	C1 Statistikat mbi sigurinë dhe mos ndëshkimin	25
A4 Liria e punës dhe shoqatave të gazetarëve	15	C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe e aktorëve politikë ndaj mbrojtjes së gazetarëve	26
A5 Mbrojtja e burimeve të informacioneve	16	C3 Sjellja e sistemit gjyqësor civil dhe penal kundër kërcënimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve	29
A6 E drejta e qasjes në informacione	17		
<b>B Pozita e gazetarëve në redaksi</b>	<b>19</b>	<b>Konkluzionet and Rekomandime</b>	<b>33</b>
B1 Kufizimet ekonomike në punën e gazetarisë	19		
B2 Pavarësia redaktoriale në mediat private	20		

# Vështrimi i përgjithshëm dhe përmbledhja e projektit

Shoqatat e gazetarëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor, me mbështetjen e Komisionit Evropian<sup>1</sup>, krijuan një platformë të përbashkët [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net) për të monitoruar ndryshimet në legjislacion dhe praktikën e vendeve të tyre dhe për t'u angazhuar në aktivitete të ndryshme avokuese që synojnë avancimin e politikës, mjedisin legjislativ dhe institucion-al në të cilin punojnë gazetarët dhe mediat. Që nga viti 2020, anëtarët e platformës monitorojnë situatën në shtatë vende (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Kosovë<sup>2</sup> dhe Serbi). Çdo vit, vlerësimi i shtetit kryhet në bazë të metodave të standardizuara për mbledhjen dhe analizën e të dhënave<sup>3</sup>, ndërsa fokusi i hulumtimit për përfaqësim është në ndryshimet, si në hapësirën tradicionale ashtu edhe në atë të mediave online në vendet e Ballkanit Perëndimor.

- 
- <sup>1</sup> INë dhjetor të vitit 2019, Komisioni Evropian miratoi projektin tre-vjeçar [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net) i cili ka për qëllim të forcojë shoqatat nacionale të gazetarëve në vendet e Ballkanit Perëndimor, në mënyrë që të bëhen aktorë të pavarur, të suksesshëm dhe të përgjegjshëm në përfaqësimin për zbatimin e standardeve të BE-së në fushën e lirive të medias, me qëllim afatgjatë për avancimin e të drejtës së qytetarëve në përzgjedhje për informim. Ky veprim paraqet ndërlidhje me projektin e mëparshëm (Platforma Rajonale për Ballkanin Perëndimor për Avokim për Lirinë e Mediave dhe Sigurinë e Gazetarëve), dhe bazohet në njohuritë dhe përvojën e ndërtuar në periudhën 2016-2018. Iniciativa mbështetet nga Programi për Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Mediave 2020-2022, Mbështetja e rrjeteve tematike rajonale të organizatave qytetare.
  - <sup>2</sup> Ky emër është pa paragjykim për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën dhe Pavarësinë e Kosovës.
  - <sup>3</sup> Edicioni i parë i Metodologjisë për këtë hulumtim të avokimit u zhvillua në vitin 2016 dhe u rregullua gjatë viteve për të pasqyruar situatën në vendet e Ballkanit Perëndimor. Hulumtimi i avokimit është projektuar dhe koordinuar nga Snezhana Trpevska dhe Igor Micevski, hulumtues në Institutin për Kërkime të Zhvillimit Social RESIS nga Maqedonia e Veriut. ([www.resis.mk](http://www.resis.mk)).

# Shënim metodologjik

Metodologjia e hulumtimit është e përbërë nga tre grupe të indikatorëve, e zhvilluar në bazë të analizës sistematike të udhëzimeve të ndryshme, të prodhuara nga organizatat ndërkombëtare relevante. Gjatë viteve të mëparshme, fillimisht u rafinuan indikatorët cilësorë të zhvilluar me qëllim që të mbulohej konteksti karakteristik socio-politik i Ballkanit Perëndimor si dhe nevojat dhe interesat specifike të gazetarëve në të shtatë vendet.

Janë aplikuar një sërë metodash të ndryshme hulumtuese për të grumbullimin dhe analizën e të dhënave me qëllim që t'u përgjigjet pyetjeve indikatore në lidhje me secilin indikator specifik:

- Rishikimi i studimeve, analizave, raporteve hulumtuese, dokumenteve të politikave, strategjive dhe dokumenteve të tjera;
- Analizë cilësore e dokumenteve ligjore;
- Kërkim dhe analiza e informacioneve të publikuar në faqet e internetit të institucioneve publike dhe organizatave dhe organeve të tjera;
- Kërkim dhe analiza e njoftimeve publike, njoftimeve dhe informacioneve të tjera të prodhuara nga organizatat profesionale;
- Të dhëna sekundare të grumbulluara nga shoqatat e gazetarëve;
- Intervista të thelluara me ekspertë, gazetarë, krijues të politikave etj.;
- Anketa me gazetarë (në disa prej vendeve).

Në nivel nacional, shoqatat e gazetarëve angazhuan hulumtues nacional për grumbullimin e të dhënave dhe për të shkruar raporte narrative, të cilat më pas u rishikuan nga ekspertë të nominuar nacional dhe studiuesit kryesorë. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë propozoi si hulumtues nacional Millan Spirovskin dhe Verçe Todorovska-Kostovska, kurse Marina Tunevën si eksperte mediatike për recensimin e raportit.

Tabela 1: Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve

A Mbrojtja ligjore	B Pozita e gazetarëve në redaksi	C Siguria e gazetarëve
A1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe zbatimimi i tyre në praktikë	B1 Kufizimet ekonomike të lirisë së gazetarëve	C1 Statistika për sigurinë dhe mosndëshkimin
A2 Efekti i ligjeve për shpifje ndaj gazetarëve	B2 Pavarësia redaktoriale në mediat private	C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe e politikanëve në mbrojtje të gazetarëve
A3 Mbrojtja e pluralizmit politik në media	B3 Pavarësia redaktoriale në radiodifuzerin publik	C3 Sjellja e sistemit gjyqësor penal dhe civil ndaj kërcënimeve dhe dhunës mbi gazetarët
A4 Liria e punës dhe shoqërimit të gazetarëve	B4 Pavarësia redaktoriale në sektorin jofitimprurës	
A5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve	B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	
A6 Mbrojtja e të drejtës për qasje në informacione	B6 Pozita ekonomike e gazetarëve	

Lista e shkurtesave

KSHZ	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
ASHMAA	Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale
RTM	Radiotelevizioni i Maqedonisë
SHGM	Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë
SPGPM	Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik
IMM	Instituti Maqedonas i Mediave
KEMM	Këshilli për Etikë në Media
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
AIM	Agjencia Informative Mediatike
IRL	Laboratori Hulumtues i Reporterëve



Republika e Maqedonisë së Veriut është demokraci parlamentare në të cilën pas çdo cikli të zgjedhjeve parlamentare qeverinë e formojnë partitë politike dominuese të cilat kanë fituar më së shumti vota nga blloku maqedonas dhe ai shqiptar. Në vitin 2022, në pushtet ishte qeveria e koalicionit LSDM dhe BDI, të cilat fituan më së shumti vota në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2020. Sipas Regjistrimit të Popullsisë dhe Amvisërive<sup>4</sup> të realizuar në vitin 2021, popullata e përgjithshme rezidente e RMV-së shënon 1,836,713 banorë. Sipas deklaramit për përkatësinë etnike, 58,44 për qind e popullsisë janë deklaruar maqedonas, 24,30 për qind shqiptarë, 3,86 për qind turq, 2,53 për qind romë, 0,47 për qind vllleh, 1,30 për qind serbë, 0,87 për qind boshnjakë dhe të tjerë. Sipas përkatësisë fetare, 46,14 për qind janë ortodoksë, 32,17 për qind myslimanë (islam), 0,37 për qind katolikë dhe një përqindje më e vogël janë deklaruar si agnostikë ose anëtarë të grupeve dhe komuniteteve të tjera fetare. Në kuadër të Regjistrimit të vitit 2021, qytetarëve të Maqedonisë që jetojnë dhe qëndrojnë jashtë vendit për më shumë se një vit iu mundësua të regjistrohen përmes një aplikacioni në internet, i cili ishte i disponueshëm në ueb faqen për Regjistrim. Këtë mundësi e kanë shfrytëzuar 258.932 mërgimtarë, prej të cilëve 24.55 për qind janë deklaruar maqedonas, 66.42 për qind shqiptarë, 4.78 për qind si turq etj. Kjo kategori e qytetarëve nuk përfshihet në numrin e përgjithshëm të popullsisë rezidente të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

<sup>4</sup> Entit shtetëror të statistikës, Rezultatet e Regjistrimit 2021, të qasshme më 21.11.2022. <https://bit.ly/3HGSTsS>

Edhe gjatë viti 2022 nuk ka pasur ndryshime në reformat e pritshme mediatiqe, nuk është zgjedhur as përbërja e re e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatiqe Audio dhe Audiovizuale dhe as Këshilli programor i Radio Televizionit të Maqedonisë. Është shtyrë edhe miratimi i ndryshimeve dhe plotësimeve në Kodin Penal<sup>5</sup>, me të cilat pritet të përforcohet mbrojtja e gazetarëve nga kërcënimet dhe sulmet ndaj tyre. I vetmi ndryshim pozitiv në aspektin e fushës ligjore ndodhi në nëntor të vitit 2022, kur në Kuvend, u votuan ndryshimet në Ligjin për Përgjegjësinë Civile për Shpifje dhe Fyerje<sup>6</sup>, me të cilat ulet masa e dëmshpërblimit për dëmin jo material për gazetarët.

Mediat janë duke vuajtur ende pasojat negative të dëmeve të shkaktuara nga pandemia, pavarësisht masave mbështetëse të Qeverisë (ndihma për punëtorët, lirimi nga taksat dhe kontributet e sigurimeve sociale, etj.) nga viti 2021. Sipas analizës së tregut<sup>7</sup> të ASHMAA për vitin 2021, të hyrat e përgjithshme në industri gjatë vitit arritën në 2.644,83 milionë denarë. Kjo është shuma më e lartë e të ardhurave të përgjithshme në pesë vitet e fundit por kjo vjen për shkak të ndihmës financiare për ballafaqimin me pasojat e pandemisë së virusit korona të cilat shteti i ndau për mediat komerciale (dedikuar për mbulimin e shpenzimeve për shumën e lejes së emetimit, të mbulohen shpenzimet e transmetimit të sinjalit, subvencionet për kontributet e pagave të punëtorëve dhe të tjera) si dhe të ardhurat që transmetuesit komercialë kishin realizuar nga reklamat e paguara politike. Në këtë mënyrë transmetuesit komercialë, në tërësi shënuan të hyra më të larta se në vitin e kaluar. Njëkohësisht Servisi Publik Radiodifuziv dispononte më pak fonde edhe krahasuar me një vit më parë.

Në fillim të vitit 2022, programe kanë emituar 44 televizione komerciale, 62 radiostacione komerciale dhe katër radiostacione jofitimprurëse. Në pesë vitet e fundit numri i transmetuesve është ulur për gjithsej 24, në fillim të vitit 2017 leje për të transmetuar programe kishin gjithsej 134 subjekte ndërsa 110 subjekte në fund të vitit 2021. Përveç transmetuesve komercialë dhe jofitimprurës ekziston edhe Servisi Publik - me 5 kanale televizive dhe 3 radio kanale. Në sektorin e mediave të shkruara janë botuar: 4 gazeta ditore (3 në gjuhën maqedonase dhe 1 në gjuhën shqipe), 2 javore dhe rreth 11 botime të tjera. Gjithashtu, ekzistojnë edhe mbi 150 media digjitale në vend. Teknologjitë e reja kanë ndryshuar tërësisht zakonet e leximit dhe informimit të audiencës. Pothuajse 80 për qind e audiencës informohet në internet.

Gazetarët dhe punonjësit e mediave vazhdojnë të jenë ekonomikisht të pasigurt, numri i atyre me kontrata pune mbetet i pakënaqshëm ndërsa në mediat private pothuajse nuk ka as marrëveshje kolektive që mbrojnë të drejtat e tyre të punës. Gjatë vitit 2022 kanë ndodhur gjithsej shtatë kërcënime dhe sulme më serioze ndaj gazetarëve prej të cilave në internet është regjistruar një kërcënim me vdekje. Nga këto shtatë kërcënime dhe sulme të regjistruara ndaj gazetarëve dhe punëtorëve mediatik, për katër raste ka pasur reagim nga rrjeti rajonal Safejournalists.net.<sup>8</sup>

5 Kuvendi i RMV-së, Propozim i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Penal. Qasur prej datës 17.11.2022. <https://www.sobranie.mk/detali-na-materijal-nspj?param=4448d2a8-7fc4-4fdc-9c2a-b43443de38c2>

6 Kuvendi i RMV-së, Propozimi i Ligjit për Përgjegjësinë Civile për Shpifje dhe Fyerje. Qasur nga 22.11.2022. <https://www.sobranie.mk/detali-na-materijal-nspj?param=ed066dab-a258-4360-9560-6729d5a9fa23>

7 ASHMAA, Analiza e tregut të shërbimeve mediatiqe audio dhe audiovizuale për vitin 2021. Shkup: 2021. Qasur nga 11.11.2022. <https://bit.ly/3BNQnxh>

8 Safejournalists.net – Reagime rajonale për 4 raste të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve të mediave në vitin 2022 <https://safejournalists.net/napadi-vrze-novinari/?lang=mk>

### **A1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe gazetarëve dhe zbatimi i tyre në praktikë**

A garantohet e drejta e lirisë së shprehjes dhe informimit? A përfshin kjo edhe qasje në internet? A zbatohen në praktikë këto garanci ligjore?

Kushtetuta si dhe ligjet për media përmbajnë të gjitha garancitë themelore për lirinë e shprehjes dhe pavarësinë e mediave, duke përfshirë të drejtën e qasjes dhe lirinë e shprehjes në internet. Vlerësimi i përgjithshëm se këto garanci zbatohen në praktikë është përsëri pozitiv, megjithëse në vitin 2022 numri i sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias u rrit nga pesë (të regjistruara në vitin 2021) në shtatë. Megjithatë, praktika e mosndëshkimit vazhdon sepse rastet e viteve të kaluara nuk janë zgjidhur dhe rezultati i rasteve të zgjidhura të kërcënimeve të reja me gjykim përfundimtar është jashtëzakonisht i vogël<sup>9</sup>. Trendin pozitiv e vërteton edhe Indeksi i Reporterëve pa Kufij<sup>10</sup> sipas të cilit në vitin 2022 Maqedonia e Veriut ishte 33 vende më lart në këtë listë dhe ishte në vendin e 57-të nga gjithsej 180 vende në botë. Një nga problemet kryesore të theksuara në raportin e Reporterëve pa Kufij është pikërisht

9 Milan Spirovski dhe Verçe Todorovska-Kostovska, "Maqedonia e Veriut - Treguesit për shkallën e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve", Shkup: 2020. Qasur më datë 14.11.2022. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2021/08/MK-MK-2020.pdf>

10 Indeksi i Reporterëve pa Kufij, "Maqedonia e Veriut: Raporti i Reporterëve pa Kufij për vitin 2021", Qasur më 17.12.2022. <https://rsf.org/en/north-macedonia>

kultura e mosndëshkimit, gjegjësisht jo efikasiteti i procedurave për sulmet ndaj gazetarëve: “Edhe pse gazetarët nuk punojnë në mjedis armiqësor, përhapja e dezinformatave dhe mungesa e profesionalizmit kontribuojnë në rënien e besueshmërisë së shoqërisë në media e cila i ekspozon mediat e pavarura në kërcënime dhe sulme.”

Kuvendi edhe gjatë vitit 2022 nuk i ka përfunduar aktivitetet e paralajmëruara për zgjedhjen dhe emërimin e organeve drejtuese në RTM dhe ASHMAA edhe përkundër kritikave dhe kërkesave rregullisht të drejtëara nga shoqatat esnafa të gazetarëve.

### A u miratuan ligjet për mediat dhe ligjet tjera të rëndësishme për gazetarët përmes procesit transparent dhe gjithëpërfshirës dhe në konsultim me organizatat profesionale relevante?

Në nëntor të vitit 2022 si nismë e një grupi të deputetëve, në mënyrë jo transparente u aktualizua përsëri propozimi për rikthimin e reklamave shtetërore nëpërmjet ndryshimeve në nenin 102 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale<sup>11</sup>. Më herët, gjatë vitit, në disa tentativa, qeveria në mënyrë jotransparente ka iniciuar ndryshime të ngjashme të Ligjit, me qëllim të rikthimit të reklamave shtetërore. Këto tentativa kanë hasur në kritika të vazhdueshme publike<sup>12</sup> nga organizatat esnafa gazetareske dhe mediatike, me arsyetimin se rikthimi i reklamave shtetërore do të forcojë më tej lidhjet financiaro-klienteliste mes mediave private dhe pushtetit dhe në mënyrë shtesë do të prishë tregun mediatik. Në argumentimin kundër reklamave shtetërore në mediat audiovizuale u theksua se shuma të mëdha të mjeteve publike do të derdhen në sektorin e mediave private për programe politike me pagesë gjatë periudhave të fushatës zgjedhore. Krahas ndikimit në pavarësinë e mediave, me këtë edhe në të drejtën e informimit të qytetarëve me qëllim që ata të jenë në mënyrë objektive dhe gjithëpërfshirëse të informuar, kthimi i fushatave të paguara qeveritare do të thotë manipulim me interesin publik nëpërmjet fushatave të cilat do të promovohen si publike por që në thelb do të realizohen për qëllime politiko-partiake të partive politike që janë në pushtet.

Pothuajse dy vite pas hartimit të propozim-amendamenteve në Ligjin për Përgjegjësinë Civile për Shpifje dhe

Fyerje, proces në të cilin anëtarët e SHGM-së morën pjesë aktive dhe dhanë kontributin e tyre, ato u miratuan nga ana e Kuvendit në nëntor të vitit 2022. Faza tjetër është që amendamentet të miratohen nga deputetët në seancë të Kuvendit. Mirëpo, ndryshimet dhe plotësimet e propozuara në Kodin Penal, me të cilat pritet të arrihet mbrojtje më e madhe e gazetarëve dhe punonjësve të medias që hynë në procedurë parlamentare në korrik të vitit 2021 nuk u miratuan nga Kuvendi as në vitin 2022. Nga ana tjetër, në maj të vitit 2022, Ministria e Drejtësisë njoftoi se ishte duke u përgatitur një projektligj i ri, i cili i është dorëzuar ENER-it<sup>13</sup> dhe i cili do të përbante të njëjtat ndryshime të propozuara por një version përfundimtar i këtij ligji nuk ishte i disponueshëm publikisht deri në fund të vitit. Pavarësisht se me kërkesë të SHGM-së është paralajmëruar debat publik për tekstin e ri të ligjit, ai nuk ka ndodhur deri në fund të vitit të kaluar. Në vitin 2020, SHGM ishte e përfshirë dhe e konsultuar gjatë përgatitjes së amendamenteve të këtyre dy ligjeve, por përkundër kësaj, vërejtja thelbësore mbetet se procesi i amendamenteve ishte i ngadaltë dhe pa një afat kohor të caktuar për miratim dhe implementim.

### A janë përpjekur autoritetet të vendosin regjistrimin ose kushte të tjera më të repta për themelimin e mediave të shtypura apo atyre në internet? A shkojnë kërkesat përtej regjistrimit të zakonshëm afarist dhe tatimor?

Në RMV nuk ka kushte të rigoze për themelimin e mediave të shkruara apo online. Mediat e shkruara i nënshtrohen rregullimit minimal në përputhje me dispozitat e Ligjit për media, lidhur me obligimet themelore për veprimtarinë e tyre publike, mbrojtjen e burimeve të informacionit, mbrojtjen e të miturve, ndalimin e gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes së dhunës, dhe disa detyrime tjera që lidhen me organizimin e brendshëm dhe aktet e nevojshme. Mediat online nuk mbulohen fare nga legjislati i medias, gjegjësisht përmbajtjet e tyre janë ekskluzivisht subjekt i vetë-rregullimit dhe mbulohen nga ligje të tjera, siç është shembulli me Kodin Penal. Që nga dhjetori i vitit 2019 funksionon Regjistri i Mediave Online<sup>14</sup>, i cili në fund të vitit 2022 kishte gjithsej 154 anëtarë. Krahas kësaj, në shkurt të vitit 2021, KEMM miratoi edhe Udhëzimet për Raportimin Etik të Mediave Online<sup>15</sup>, të cilat anëtarëve të Regjistrimit si dhe mediave të tjera online u japin udhëzime dhe rekomandime më të detajuara për zbatimin e Kodit të Gazetarëve gjatë raportimit online. Në gjysmën e dytë të vitit 2022 u mba-

11 K. Blazevska, “Dora që jep, nuk thahet: Reklamata qeveritare janë kthyer!”, Deutsche Welle, 16.11.2022. Qasur më 21.12.2022.

12 SHGM, SPGPM, IMM dhe KEMM, “Organizatata esnafa gazetareske dhe mediatike janë kundër legalizimit të korrupsionit mediatik përmes rikthimit të fushatave në media”, 08.04.2022, Qasur më 21.12.2022. <https://bit.ly/3iKPNKa>

13 Projekt-propozim i Kodit Penal 4.5.2022 [https://energov.mk/Default.aspx?item=pub\\_regulation&subitem=view\\_reg\\_detail&itemid=74071](https://energov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=74071)

14 Regjistri i mediave profesionale online - Promedia. [www.promedia.mk](http://www.promedia.mk)

15 KEMM, “Udhëzime për raportimin etik të mediave online”, Qasur më 17.12.2022. <https://www.semm.mk/dokumenti/korisni-resursi/kodeksi/850-nasoki-za-etichko-izvestuvanje-na-onlajn-mediumite>

jt një takim koordinues në organizimin e disa mediave profesionale online, në të cilin u harmonizuan rregullat e reja për anëtarësim në Promedia, Regjistri i Mediave Profesionale Online. Qëllimi i këtyre rregullave të reja është në vazhdim të direktivave dhe akteve<sup>16</sup> për mediat, rishtazi të miratuara të Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian, për vendosjen e më shumë rregullave në gazetarinë online nëpërmjet qasjes vetërregulluese, proces që e mbështet edhe Bashkimi Evropian dhe pret rezultate më të mëdha nga ai.

### **A janë përpjekur autoritetet të kufizojnë të drejtën e qasjes në internet ose të kërkojnë bllokimin ose filtrimin e përmbajtjes së internetit?**

Në vitin 2022, ashtu si edhe një vit më parë, nuk pati asnjë rast të vetëm të regjistruar apo të dokumentuar ku qeveria apo autoritetet tjera shtetërore të tentonin të bllokonin ose filtronin përmbajtjet në internet. Me përjashtime të rralla, vlerësimi edhe për këtë vit është se e drejta e lirisë së shprehjes në hapësirën e internetit shfrytëzohet lirisht nga qytetarët, gazetarët, mediat dhe organizatat tjera.

### **A e kryen Organi rregullator misionin dhe funksionet e tij në mënyrë të pavarur dhe jodiskriminuese? A zbatohet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme procesi i licencimit dhe rregulloret tjera për emetim?**

Ashtu si gjatë vitit të kaluar edhe në vitin 2022, SHGM nuk ka dokumentuar asnjë rast në bazë të cilit ASHMAA do të vlerësohej si një organ i cili është nuk është i pavarur ose që nuk vepron në mënyrë të drejtë dhe neutrale ndaj subjekteve mbi punën e të cilave kryen mbikëqyrje. Sa i përket funksionimit të rregullatorit, vërejtja kryesore iu drejtua edhe një herë Kuvendit i cili për shkak të mungesës së konsensusit politik mes partive më të mëdha ende nuk ka bërë zgjedhjen e anëtarëve të përbërjes së re të Këshillit të ASHMAA-së edhe pse mandati i anëtarëve ekzistues prej kohësh ka skaduar. Kjo tregon se përpjekjet për ndikim politik në punën e Organit rregullator janë ende të pranishme.

### **A ekzistojnë dispozita ligjore që kanë të bëjnë me reklamën shtetërore në media dhe a keqpërdoren ato për ndikim politik në politikën e tyre redaktuese? A bëhet shpërndarja e fondeve shtetërore në mënyrë transparente, të drejtë dhe jodiskriminuese? A i publikojnë rregullisht institucionet shtetërore të dhëna për shumata e akorduara për media të ndryshme?**

Pas praktikës disavejçare negative të shpërndarjes së shumave të mëdha të mjeteve buxhetore për mediat private, nga dhjetori i vitit 2018, me ndryshimet në nenin 102 të Ligjit për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale shpallja e reklamave shtetërore në sektorin audiovizuel u ndalua plotësisht. Gjatë viteve në vijim, megjithëse ky ndalim u respektua formalisht nga Qeveria, në nivel lokal, disa komuna dhe ndërmarrje publike nuk e respektuan atë dhe një pjesë të konsiderueshme të mjeteve të tyre i ndanë për mediat private lokale, gjë që ndikoi negativisht në pavarësinë redaktuese të tyre. Paralelisht me këtë, në vitet e fundit ka pasur disa përpjekje nga pushteti, nën presionin e televizioneve private në nivel shtetëror, që fushata publike të financuara nga buxheti shtetëror të rikthehen. Vetëm në vitin 2022 kishte dy përpjekje të tilla: e para në maj dhe e dyta në nëntor të vitit 2022. SHGM dhe organizata të tjera gazetareske dhe mediatike reagues publikisht ndaj të gjitha përpjekjeve të tilla<sup>17</sup>, duke argumentuar se kjo do të ndikonte në pavarësinë redaktuese të mediave dhe do të përforconte klientelizmin. Qëndrimi i SHGM-së është se duhet gjetur një mënyrë për të ndihmuar mediat private në veçanti kur kriza financiare është thelluar por kjo duhet të bëhet nëpërmjet një mekanizmi transparent dhe jo diskriminues. Sipas SHGM-së, një zgjidhje cilësore dhe afatgjate është krijimi i një fondi i cili do të mbështesë përmbajtje me interes publik, me të cilat do të promovohet diversiteti rajonal dhe lokal, produktet gazetareske, gazetaria investigative dhe analitike si dhe produktet dokumentare, edukative dhe artistike. Në këtë mënyrë do të inkurajohej gazetaria dhe prodhimi i përmbajtjeve të reja ndërsa kjo do të ndikonte edhe në përmirësimin e statusit dhe të ardhurave të gazetarëve dhe punëtorëve mediatikë.

### **A ekzistojnë subvencione apo fonde mediatike për prodhimin e përmbajtjeve mediatike me interes publik dhe si zbatohen ato në praktikë?**

Qeveria e RMV-së në vitin 2021 për herë të katërt miratoi Programin për mbështetje për shtyp dhe distribuim të mediave të shtypura në vlerë prej 20 milionë de-

<sup>16</sup> Instituti Maqedonas për Media, "Rregulla të reja të lojës për mediat në Evropë", Shkup: 2022. Qasur më 17.12.2022. <https://bit.ly/3GHCr9q>

<sup>17</sup> SHGM, KEMM DHE IMM "Nuk na duhet reprizë me fushata publike të paguara në media", 4.5.2021. Qasur prej datës 09.11.2022. <https://bit.ly/3BXrXju>

narëve, shumë e cila është dukshëm më e ulët në krahësim me tri vitet e fundit<sup>18</sup>. Programi zbatohet me qëllim që të mbështeten mediat e shtypura me karakter të përgjithshëm dhe informativ. Për ndarjen e mjeteve vendos komisioni në të cilin përveç përfaqësuesve të institucioneve kompetente bëjnë pjesë edhe nga një përfaqësues i Asociacionit për Mbrojtjen e Mediave të Shtypura Nacionale dhe i SHGM-së. Komisioni për vitin 2022 ka marrë vendim në bazë të kriterëve të përcaktuara qartë dhe shumta e mbështetjes së miratuar është përcaktuar në bazë të faturave të dorëzuara për vitin kalendarik 2021.

### Cilat janë mekanizmat për financimin e mediave në gjuhët e bashkësive?

Programet radiotelevizive në gjuhët e bashkësive etnike që jetojnë në RMV transmetohen në kuadër të Servisit Publik Radiodifuziv si dhe në kanalet programore të transmetuesve privatë. Në fund të vitit 2022 në sektorin e radiodifuzionit funksiononin gjithsej 43 televizione dhe 64 radio që transmetonin programe.<sup>19</sup> Prej tyre, 19 televizione dhe 13 radio stacione kanë raportuar programe në një ose më shumë gjuhë të bashkësive etnike. Megjithatë, gjuha më e zakonshme në të cilën transmetohen programe është gjuha shqipe ndërsa komunitetet më të vogla etnike (turqit, romët, vllehtë, serbët dhe boshnjakët) pothuajse nuk kanë qasje në programet e televizioneve dhe radiove private. Nuk ka asnjë mekanizëm për mbështetje financiare të diversitetit gjuhësor në radiodifuzion dhe as nuk është ndërtuar politikë mediatike për zgjidhjen e këtij problemi i cili ndikon negativisht në pluralizmin mediatik të vendit.

### A janë të garantuara dhe të mbrojtura në mënyrë efektive pavarësia dhe autonomia e Servisit publik radiodifuziv? A siguron korniza e financimit pavarësinë dhe funksionimin e tij të qëndrueshëm? A e përfaqësojnë organet mbikëqyrëse shoqërinë në tërësi?

Gjatë vitit 2022 nuk kishte asnjë progres në drejtim të reformave të servisit publik. Autonomia dhe pavarësia e tij janë kërkesa të qarta në rregulloren ligjore por korniza e financimit akoma mbetet kusht për shqetësim më të madh për faktin se Qeveria ka të drejtën diskreionale të vlerësorë çdo vit nëse servisit publik do të ndajë përqindjen e buxhetit të përcaktuar me ligj. Në mënyrë që të përfaqësojë shoqërinë në tërësi nuk është zgjedhur ende organi i cili mbikëqyrë servisin publik dhe si-

pas metodës së re të përzgjedhjes së parashikuar me ligj, nuk është bërë as në vitin 2022 zgjedhja e përbërjes së re të këtij trupi. Vendim formal nuk ka por në ndryshimet e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale të vitit 2018 parashikohet që mandatet e anëtarëve të shtyhen deri në përzgjedhjen e anëtarëve të rinj. Ndryshe, reforma në servisin publik ishte një nga çështjet kyçe të përkrahura nga sektori joqeveritar dhe ndërlidhej fillimisht me financimin e pavarur dhe të qëndrueshëm të transmetuesit si dhe me nevojën për të siguruar pavarësinë e tij përmes zgjedhjes së anëtarëve të rinj të Këshillit Programor i cili mbikëqyr funksionimin e servisit publik në emër të shoqërisë civile. Financimi i RTM-së u ndryshua tërësisht në vitin 2018 kur u kalua nga taksa radiodifuzive (pagesë publike) në një përqindje fikse të buxhetit të RMV-së, me qëllim që të sigurohet financim afatgjatë dhe i qëndrueshëm. Përkundër kësaj, RTM-ja ende ballafaqohet me probleme financiare për shkak të borxheve nga vitet e kaluara si dhe për faktin që qeveria nuk i ka paguar plotësisht mjetet e saj sipas dinamikës së parashikuar me ligj.

Në nëntor të vitit 2022, SHGM së bashku me Këshillin Programor të RTVM-së ka bërë një reagim<sup>20</sup> të përbashkët në kontekst të zvogëlimit të buxhetit të Servisit Nacional Publik. Këshilli programor pranë RTM-së dhe SHGM informuan se në muajin nëntor në Kuvendin e RMV-së janë propozuar ndryshime në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, me të cilat është paraparë zvogëlim i buxhetit vjetor të RTM-së. Këto ndryshime ishin planifikuar të miratohen me procedurë të shkurtuar, në mënyrë jo transparente dhe pa përfshirjen e përfaqësuesve të servisit publik, shoqatave gazetareske dhe ekspertëve publik. Ndryshimet kishin paraparë mjete nga buxheti të dedikuara për financimin e veprimtarisë radiodifuzive dhe ASHMAA të ulen nga 1 në 0.9 për qind nga të ardhurat e përgjithshme të realizuara në vitin i cili i paraprin vitit fiskal. Ndërkohë, ishte planifikuar të hiqet ndalimi i reklamave shtetërore të përcaktuara në nenin 102, që do të thotë se mjetet në vlerë prej rreth pesë milionë eurove, në vend që të transferohen për zhvillimin e veprimtarisë radiodifuzive publike do t'i kalonin televizioneve dhe radiove private për të ashtuquajturat fushata me interes publik. Ky model është në dëm të RTM-së dhe e kërcënon më tej situatën financiare edhe ashtu të brishtë në të cilën transmetuesi publik vazhdon të ekzistojë prej vitesh. Nga ana tjetër, obligimet programore të RTM-së madje janë shtuar me hapjen e kanalit 24-orësh në gjuhën shqipe dhe serviset e reja tematike (kanale për fëmijë dhe sport).

18 Qeveria e RMV, "Programi për mbështetjen për shtypin dhe distribuimin e mediave të shtypura për vitin 2021"; Shkup, 2021. Qasur prej dt. 10.1.2021. <https://bitly/3994oKb>

19 ASHMAA, Regjistri i radiodifuzerëve Tv dhe radio. Qasur më 16.12.2022. <https://avmu.mk/radiodifuzeri-mk/>

20 Njoftimi i SHGM-së, "Buxheti i RTVM-së është duke u zvogëluar në mënyrë jotransparente"; 19.11.2022, Qasur më 18.12.2022. <https://bit.ly/3HMrGF3>

## A2 Efekti i ligjeve për shpifje ndaj gazetarëve

A janë shumë strikte dispozitat ligjore për shpifje dhe a i mbrojnë të njëjtat funksionarët shtetërorë? Cilat janë mangësitë kryesore të këtyre ligjeve?

Dy vjet pas përgatitjes së propozimit, në nëntor të vitit 2022, u votuan dispozitat e ndryshuara të Ligjit për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje. Qëllimi i propozimeve të SHGM-së ishte zvogëlimi i gjobave të parashikuara me qëllim që ato mos të ndikojnë negativisht në gazetarinë e lirë dhe kritike. Ligji garanton lirinë e shprehjes ndërsa kufizimet e mundshme në rastet e prekjes së reputacionit dhe dinjitetit rregullohen në përputhje me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (neni 10) dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Mangësia kryesore e ligjit ishte masa e dëmshpërblimit që gjykata mund t'i jepte gazetarit si kompensim për dëmin jomaterial të shkaktuar nga fyerja ose shpifja por me ndryshimet e miratuara ky rrezik ndjeshëm është ulur.

Sa padi janë ngritur kundër gazetarëve nga funksionarët shtetërorë gjatë vitit të kaluar? A janë aktvendimet e gjykatës të motivuara politikisht kundër gazetarëve? Çfarë janë dënimet e shqiptuara?

Gjatë viteve të fundit, me përjashtime të vogla, paditë për shpifje dhe fyerje nuk kanë shkaktuar presion mbi gazetarinë profesionale. Shembull në vitin 2012, ishin 330 procese gjyqësore<sup>21</sup> kur kjo vepër u de-kriminalizua dhe në vitet në vijim numri u ul ndjeshëm: në vitin 2016 ishin 40, 39 në vitin 2017 dhe 33 raste në vitin 2020, në të cilat palët ishin gazetarët ose mediuimet. Sipas të dhënave të marra nga Gjykata Themelore Civile Shkup, në vitin 2022 numri i padive për shpifje dhe fyerje është rritur, kështu që numri i përgjithshëm i lëndëve aktive në të cilat palët janë gazetarë apo media është rritur në 54 për dallim nga viti 2021 i cili shënonte 20. Megjithatë, sipas të dhënave që disponon SHGM, gjatë vitit nuk është kryer asnjë procedurë e vetme në të cilën një gazetar apo medium është dënuar për fyerje apo shpifje.

A e njohin gjykatat mekanizmin vetërregullues (nëse ka)? A e pranojnë ata vlefshmërinë e përgjigjes, korrjigjimit apo faljes së publikuar?

Vlerësimi nëse gjykatat i njohin dhe i pranojnë vendimet e Komisionit për ankesa pranë Këshillit të Etikës në Media është i njëjtë si në vitet e mëparshme. Sipas avokatëve që përfaqësojnë gazetarët për shpifje ose fyerje në proceset gjyqësore është praktikë e përgjithshme është që gjyqtarët të marrin parasysh vendimet e Këshillit. Në një praktikë të tillë kontribuon edhe fakti që vetë avokatët mbështeten në vendime të tilla gjatë mbrojtjes së gazetarëve.

*„E rëndësishme është që Gjykata të pranojë vendimin e trupit vetërregullues si argument për zbutjen e dëmit, në veçanti kur gazetari apo media ka publikuar një kërkim falje dhe ka tërhequr tekstin e kontestuar, gjë që rregullohet me vetë Ligj. Prandaj, Gjykata duhet të respektojë faktin se me vendimin e organit vetërregullues është zbutur dëmi, gjegjësisht i janë plotësuar të drejtat personale të dëmtuarit.”- Ivan Breshkovski, ekspert juridik dhe avokat<sup>22</sup>*

Çfarë mendojnë gazetarët për Ligjin për shpifje? A janë të dekurajuar të hulumtojnë dhe të shkruajnë në mënyrë kritike?

Edhe pse shumica e gazetarëve pajtohen se paditë për shpifje dhe fyerje janë përdorur më shumë si instrument presioni në të kaluarën edhe në vitin 2022 ka pasur tentativa të tilla. Rasti më karakteristik është padia e ngritur nga klinika “Zhan Mitrev” dhe mjeku Zhan Mitrev ndaj redaksisë IRL dhe gazetarëve autorë të hulumtimit “Gjaku i papastër”, e bashkangjitur me propozim deri te Gjykata për sjelljen e masës së përkohshme, e cila përfshin fshirjen e posteve dhe ndalimin e raportimit të mëtejshëm deri sa zgjat procesi gjyqësor. Pasi ekipi juridik i IRL-së, i siguruar me mbështetjen e SHGM-së, më 17 tetor të vitit 2022 dërgoi përgjigje ndaj padisë dhe propozimit për masë të përkohshme. Gjykata e refuzoi kërkesën për vendosjen e një mase të tillë.

21 SHGM, Analizë: “Aktgjykimet për shpifje dhe fyerje për lëndët gjyqësore me gazetarë”, Shkup, 2018. Qasur prej dt.: 21.12.2022. <https://znm.org.mk/analiza-presudiza-kleveti-i-navredi-n/>

22 Ivan Breshovski, ekspert juridik dhe avokat, i intervistuar më datë 05.12.2022

### A3 Mbrojtja e pluralizmit politik në media

A rregullohet pluralizmi politik në media në legjislacionin e medias jashtë periudhave zgjedhore? Cilat janë përgjegjësitë e servisit publik dhe radiodifuzerëve privatë në lidhje me pluralizmin politik jashtë periudhës zgjedhore?

Nuk ka asnjë detyrim të qartë për të mbrojtur "pluralizmin politik" në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale i cili i referohet raportimit të rregullt kur nuk është koha e fushatës zgjedhore. Raportimi i balancuar i pikëpamjeve të ndryshme politike është një nga parimet për kryerjen e veprimtarisë të rregulluar në nenin 61<sup>23</sup>. Në periudhën nga shpallja e zgjedhjeve e deri në fillimin formal të fushatës zgjedhore, rregullatori i referohet këtyre dispozitave kur pason raportimin e transmetuesve. Për Servisin Publik, ky detyrim rregullohet më hollësisht edhe në nenin 110<sup>24</sup> dhe 111<sup>25</sup>.

A është Organi rregullator i detyruar të monitorojë dhe mbrojë pluralizmin politik jashtë periudhës zgjedhore?

Në kompetencat e përgjithshme të Rregullatorit gjithashtu theksohet se "kujdeset për mbrojtjen dhe zhvillimin e pluralizmit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale", çka nënkupton se ky organ duhet të vlerësojë herë pas here këtë aspekt të pluralizmit mediatik. Rregullatori në të kaluarën ka miratuar një Manual të posaçëm për vlerësimin e pluralizmit në mediat audiovizuale<sup>26</sup> por nuk janë bërë analiza të reja për situatën me pluralizmin politik.

A kanë partitë politike dhe kandidatët qasje të drejtë dhe të barabartë në media jashtë periudhës zgjedhore?

Gjatë vitit 2022 nuk është realizuar apo publikuar asnjë analizë e pluralizmit politik në mediat audiovizuale për periudhën jashtë zgjedhore. Megjithatë, krahasuar me periudhën deri në vitin 2016 kur kishte një çekuilibrë të dukshëm në raportimin e televizioneve më me ndikim në favor të partisë në pushtet, në vitet e fundit duke përfshirë vitin 2022, perceptimi i përgjithshëm është se situata është përmirësuar<sup>27</sup>.

Cilat janë detyrimet ligjore të mediave gjatë proceseve zgjedhore? Cili organ i monitoron mediat elektronike dhe të shtypura?

Kodi Zgjedhor rregullon në mënyrë të detajuar detyrimet e Servisit Publik dhe të mediave private gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, ndërsa monitorimin mbi zbatimin të këtyre detyrimeve e kryen ASHMAA. Detyrimi për të respektuar parimin e proporcionalitetit vlen për të gjithë transmetuesit kurse rregullat më komplekse vlejné për strukturën e lajmeve në Servisin Publik: 30 për qind kronika për ngjarjet e përditshme nga vendi dhe bota, 30 për qind për aktivitetet e partive politike në pushtet, 30 për qind për aktivitetet e partive politike të opozitës parlamentare dhe 10 për qind për aktivitetet e partive politike që nuk janë të përfaqësuara në Parlament. Gjithashtu, ka edhe një sërë detyrimesh të tjera: për publikimin falas në media (për Servisin Publik), për maksimumin e lejuar dhe mënyrën e shpërndarjes së kohës për reklamat politike, ndalimin e raportimit gjatë heshtjes zgjedhore, për mënyrën e publikimit të rezultateve nga anketat parazgjedhore etj. Dispozitat për reklamat politike me pagesë janë objekt më i madh shqetësues pasi partitë politike reklamojnë me mjete të buxhetit, gjë që kërcënon pavarësinë e politikës redaktuese të mediave. Me qëllim të përgatitjes së anketës në vitin 2022, SHGM ka paraqitur kërkesë në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) për marrjen e të dhënave se cilat parti politike dhe sa mjete financiare kanë paguar në mediat online për reklama politike gjatë zgjedhjeve lokale. Procesi ka qenë i ndërlikuar në kuptimin që fillimisht nuk janë ofruar të dhëna me interes publik, kështu që duke përdorur mekanizmin ligjor për kundërshtim dhe ankimim përmes Agjencisë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacionin Publik, janë dorëzuar të dhënat në SHGM. Me aksesin e vështirë në të dhëna dhe konstatimet për shumtë e larta të akordurara për mediat online, disa prej të cilave aktualisht nuk ekzistojnë, lindin dyshime për krijimin e qëllimshëm të

23 Neni 61 i "Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale" e rregullon parimin për "prezantim objektiv dhe të paanshëm të ngjarjeve me trajtim të barabartë të pikëpamjeve dhe mendimeve të ndryshme dhe mundësimin e formimit të lirë të mendimit të publikut për ngjarje dhe çështje të caktuara"; <https://bit.ly/3NlJmqa>

24 Në nenin 110 të "Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale" përcaktohet obligimi i Servisit Publik: "të sigurojë informim të vazhdueshëm, të saktë, të plotë, të paanshëm, të drejtë dhe në kohë duke krijuar dhe emetuar programe me cilësi të lartë për të gjitha ngjarjet e rëndësishme politike, ekonomike, sociale, shëndetësore, kulturore, arsimore, shkencore, religjioze, ekologjike, sportive dhe për ngjarje dhe zhvillime të tjera..."; <https://bit.ly/3NlJmqa>

25 Neni 111, i cili i referohet standardeve dhe parimeve gjatë prodhimit ose transmetimit të programeve të Servisit Radiodifuziv, i kushton disa pika çështjes së pluralizmit dhe balancimit në programet e RTM-së. Pika 2 i udhëzon gazetarët dhe redaktorët e RMT-së që "t'i përmbahen parimit të pikëpamjeve të balancimit politik dhe pluralizmit".

26 ASHMAA, "Doracak për vlerësimin e pluralizmit politik", Shkup: 2012. Qasur më dt: 24.11.2022. <https://bit.ly/3NEJBxT>

27 Dejan Georgijevski nga Qendra për Zhvillimin e Mediave, i intervistuar më 19.11.2022.



këtij lloji të mediave vetëm që të paguohen për fushata politike, gjë që konsiderohet mangësi në sistem.

#### **A kanë partitë politike dhe kandidatët qasje të drejtë dhe të barabartë në media gjatë proceseve zgjedhore?**

Në vitin 2022 nuk kishte cikël zgjedhor në vend andaj edhe nuk mund të bëhet asnjë vlerësim për këtë vit. Sipas të dhënave nga monitorimi i cikleve të mëparshme zgjedhore<sup>28</sup>, qytetarët në përgjithësi marrin sasi shumë të madhe të informacioneve të ndryshme për gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje. Gjatë fushatës për zgjedhjet lokale në vitin 2021, janë vërejtur devijime kryesisht të radiodifuzerët privatë të cilët nuk i kanë zbatuar siç duhet parimet e barazisë për kandidatët për kryetarë të komunave dhe proporcionalitetin për kandidatët për këshilltarë komunal. Duhet theksuar se ka gjithashtu kufizime objektive për mediat në zbatimin e këtyre parimeve me një numër kaq të madh kandidatësh<sup>29</sup>.

#### **A4 Liria e punës dhe shoqatave të gazetarëve**

##### **A duhet që gazetaret të jenë të licencuar nga shteti që të mund të punojnë? A ka pasur tentativa për marrjen e lejeve nga shteti gjatë vitit të kaluar?**

Profesioni i gazetarit nuk është subjekt i licencimit dhe nuk ka pasur as tentativa nga shteti për vendosjen e ndonjë kushti që dikush të mund të punojë si gazetar. Dispozitat e Ligjit për Media tashmë janë të vjetruara, veçanërisht në lidhje me definicionin përkufizues të termit gazetar<sup>30</sup>.

##### **A ishin gazetaret të refuzuar të raportojnë nga vende apo ngjarje të caktuara për shkak se nuk kishin akreditim?**

Në vitin 2022 nuk ishte shënuar asnjë rast ku një gazetar të ishte penguar apo refuzuar të raportojë nga ndonjë ngjarje për shkak se nuk ka pasur akreditim apo dokument tjetër. Por ka raste kur përfaqësues të institucioneve publike refuzojnë t'u japin informacion gazetarëve ose të ju "vështirësojnë" raportimin nga ngjarjet e rëndësishme. Një rast i tillë gjatë vitit 2022 është sjellja e gjyqtarës ndaj gazetarit Kristian Llandov, i cili kishte ardhur për të raportuar për një seancë publike gjyqësore. "Gazetari Kristian Llandov, në nëntor të vitit 2022, ishte në detyrë gazetareske në Gjykatën Civile në Shkup, për të raportuar nga shqyrtimi kryesor për agjencinë Makfax dhe median A1on.mk. Para fillimit të seancës gjyqësore, gjykatësja Todorova i kërkoi Llandovit kartelën identifikuese të gazetarit dhe pasi që u konstatua se ajo ishte lëshuar në mënyrë legjitime nga punëdhënësi, u ul në seksionin e veçuar për publikun. Kur gjyqtarja përfundoi regjistrimin e të pranishmëve të tjerë, me ton të lartë kërkoi nga ai që të mos regjistronte, të mbyllte kompjuterin dhe të largohej nga salla e Gjyqit. Llandov u përgjigj se ai nuk po regjistronte dhe se kishte për qëllim vetëm të merrte shënime në kompjuter në mënyrë që të transmetonte me saktësi pjesë të dëgjimit publik. Gjyqtarja iu drejtua përsëri me ton të lartë, me fjalët: "Nuk keni ju çka të kapni shënime, gjykata mban procesverbal, jo ju. Mblidhni gjithçka!"<sup>31</sup> Për këtë rast, gazetari Llandov, me mbështetjen e SHGM-së ka paraqitur ankesë në Këshillin Gjyqësor për sjelljen e gjyqtarës.

##### **A janë dhe si janë të organizuar gazetaret në shoqata profesionale? A ka presione mbi shoqatën e tyre apo ndaj ndonjërit nga anëtarët?**

Gjatë vitit 2022 nuk ka pasur pengesa apo presione ndaj shoqatave të gazetarëve. Gazetarët janë të lirë të organizohen në shoqatat e tyre. SHGM është një shoqatë udhëheqëse e gazetarëve, e cila funksionon që nga viti 1946 dhe është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve dhe Federatës Evropiane të Gazetarëve. SHGM është një organizatë masive e cila ka 1111 anëtarë ndërsa në Kuvendin Zgjedhor të zhvilluar më 3 dhjetor të vitit 2022 ku morrën pjesë 485 anëtarë të rregullt me të drejtë vote, që është një numër rekord i anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote në një ngjarje statutores në historikun e punës së kësaj shoqate.

28 ASHMAA, "Raport për raportimin mediatik në raundin e parë nga fushata për "Zgjedhjet Lokale 2021"; Shkup, 2021. Qasur prej dt. 24.12.2021. <https://bit.ly/3BXqck6>

29 ASHMAA, "Pasqyrë e procedurave të ngritura kundërvajtëse nga ASHMAA për zgjedhjet lokale 2021"; Shkup, 2021. Qasur prej dt. 26.1.2021. <https://avmu.mk/lokalni-izbori-2021/>

30 Në nenin 2 të "Ligjit për media", termi gazetar përkufizohet si "person që grumbullon, analizon, përpunon ose klasifikon informacioneve të publikuara në media dhe është i punësuar në media apo ka kontratë pune me to apo person që realizon aktivitetet gazetareske si profesion i pavarur (gazetar i lirë)" <https://bit.ly/35unYiP>

31 Njoftimi i SHGM-së, "Ankesë në Këshillin Gjyqësor për shkelje të së drejtës së kolegut Kristijan Llandov për raportim nga seanca gjyqësore", 15.11.2022, <https://bit.ly/3Wq9pEM>

A organizohen gazetarët në sindikata dhe si? A ka presione mbi drejtuesit e sindikatave dhe anëtarët e tjerë? A janë të lirë gazetarët të anëtarësohen në sindikata?

---

Gjatë vitit 2022 nuk ka pasur presione serioze mbi kryesinë e SPGPM-së dhe e njëjta të shënohet publikisht; SPGPM mbetet e vetmja sindikatë nacionale që bashkon gazetarët dhe punëtorët e mediave në Maqedoni. Gjithsesi janë regjistruar presione të veçanta mbi kryesinë dhe anëtarët e SPGPM-së, lidhur me anëtarësimin e gazetarëve në sindikatë por edhe me qëndrimin e SPGPM-së kundër heqjes së ndalesës së reklamave shtetërore në mediat private audiovizuale. SPGPM është themeluar në vitin 2010 dhe është anëtare e plotë e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (e cila bashkon sindikatat e gazetarëve nga e gjithë bota), si dhe e Federatës Evropiane të Gazetarëve. SPGPM bashkon gazetarë, video dhe fotoreporterë si dhe punonjës të tjerë të mediave që janë përfshirë në procesin e prodhimit të përmbajtjeve. Aktualisht SPGPM ka mbi 300 anëtarë aktivë por numri ndryshon.

A ekziston Këshilli për Etikë në Media dhe si organizohet ky organ? A ka presione mbi përfaqësuesit e Këshillit për Etikë?

---

Organi vetërregullues - Këshilli për Etikë në Media të Maqedonisë (KEMM) ekziston që nga dhjetori i vitit 2013. Në kuadër të saj, në bazë vullnetare janë të anëtarësuar mediat dhe organizatat profesionale mediatike. Anëtarët e KEMM-it janë të obliguar të respektojnë Kodin e Gazetarëve të Maqedonisë dhe vendimet e Komisionit për Ankesa të këtij organi. KEMM dhe SHGM në vitin 2019 formuan Regjistrin e Mediave Profesionale Online, me qëllim që të rritet profesionalizmi dhe cilësia e raportimit në mediat online<sup>32</sup>. KEMM nuk përballlet me presione serioze publike, me përjashtim të rrethanave në të cilat ka ndodhur një komunikim jo i durhur publik nga drejtuesit e disa televizioneve të mëdha nacionale. Për qëndrueshmëri dhe stabilitet afatgjatë, ky organ ka ende nevojë për mbështetje të fuqishme nga komuniteti profesional mediatik, shteti dhe komuniteti ndërkombëtar i donatorëve. Në SHGM, si një mekanizëm i brendshëm vetërregullues funksionon edhe Këshilli i Nderit i cili monitoron respektimin e Kodit të Gazetarëve nga gazetarët anëtarë të SHGM-së.

## A5 Mbrojtja e burimeve të informacioneve

---

Si garantohet konfidencialiteti i burimeve gazetareske me ligj? Në çfarë kushtesh mund të kufizohet e drejta për mbrojtjen e burimeve?

---

E drejta për mbrojtjen e burimeve gazetareske është e garantuar dhe e rregulluar në detaje në Kushtetutën e RMV-së dhe në disa ligje: Ligji për mediat, Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale, Ligji për përgjegjësinë civile për fyerje dhe shpifje, Kodi Penal dhe Ligji për Mbrojtjen e Denoncuesve. Vitet e fundit, përfshirë edhe vitin 2022, janë respektuar dispozitat e këtyre ligjeve, gjegjësisht SHGM nuk ka shënuar raste ku gazetarëve i është kufizuar e drejta për mbrojtjen e burimeve.

A ka shembuj kur janë shqiptuar sanksione kundër gazetarëve që kanë refuzuar të zbulojnë identitetin e burimeve të tyre?

---

Ashtu si gjatë dy vitet e fundit edhe në vitin 2022, me kërkesë të gazetarëve nuk është regjistruar asnjë rast për të zbuluar burimin si dhe as sanksionimi që kanë refuzuar të zbulojnë identitetin e burimit. Rasti i tillë i fundit është vërejtur në vitin 2019<sup>33</sup>.

A munden lirshëm gazetarët të kenë akses dhe të zhvillojnë kontakt me burimet e informacioneve?

---

Në SHGM gjatë vitit 2022 nuk ka pasur raportime për presione të mundshme ndaj gazetarëve në lidhje me zbulimin e burimeve të tyre konfidenciale, ndërsa gazetarët që punojnë në tekste hulumtuese ndjehen të lirë të kontaktojnë burimet. Megjithatë, numri i individëve të punësuar që raportojnë rastet e korrupsionit tek autoritetet kompetente dhe tek gazetarët është ende i vogël edhe pse Ligji për Mbrojtjen e Denoncuesve<sup>34</sup> garanton të drejtat e denoncuesve dhe rregullon raportimin e mbrojtur. Në këtë drejtim, burimet gazetareske inkurajohen dhe mbrohen institucionalisht më mirë por

33 *Bëhet fjalë për akuzën parashtruar kundër gazetarit të portalit Infomaks për publikimin e procesverbalit nga një rast aktiv në Prokurori, në lidhje me çka SHGM-ja ka reaguar, duke theksuar se "Prokuroria nuk duhet t'i ndjekë ata që i kanë publikuar dokumentet, por personin që ka pasur qasje në dokumentet sekrete zyrtare dhe i ka nxjerrë për t'i dhënë një media sepse ndjekjet e këtilla gjyqësore për më tepër mund të krijojnë efekt negativ mbi lirinë e shprehjes dhe të nxjerrin vetë-censurën tek gazetarët..."*

34 *"Ligji për Mbrojtjen e Denoncuesve" 2016. Qasur prej dt. 9.12.2021. <https://bit.ly/35u7pU9>*

32 *Rregullat për anëtarësimin e internet-portaleve në Regjistrin janë në dispozicion në <https://www.semm.mk/chlenstvo/pravila-za-chlenstvo>*

për shkak të presioneve dhe frikës për vendin e punës njerëzit rrallë guxojnë ta shfrytëzojnë këtë mekanizëm<sup>35</sup>.

## A6 E drejta e qasjes në informacione

Cilat janë rregullat ligjore për qasjen në dokumentet dhe informacionet zyrtare që janë të rëndësishme për gazetarët? A i shfrytëzojnë këto rregulla gazetarët? A i respektojnë institucionet rregullat pa i prolonguar ato?

Me ndryshimet e Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me karakter Publik, nga maji i vitit 2019 u reduktuan afatet për përgjigjen e institucioneve në kërkesat për qasje deri informata, gjë që ishte veçanërisht e rëndësishme që gazetarët ta përdorin këtë ligj më shpesh gjatë punës së tyre. Dispozitat e këtij ligji përdoren më së shumti nga gazetarët që punojnë në fushën e gazetarisë hulumtuese por edhe ata ankohen që institucionet shpeshherë nuk i respektojnë afatet dhe ndonjëherë përmbajtja e informacionit të dhënë nuk korrespondon me kërkesën që iu drejtohet<sup>36</sup>.

Deri në 19 dhjetor të vitit 2022, në Agjencinë për Mbrojtjen e Qasjes së Lirë në Informata me karakter Publik janë dorëzuar 327 ankesa nga kërkuesit e informacioneve, prej të cilave 25 nga gazetarë, gjë që vërteton se dispozitat e këtij ligji ende përdoren pak nga gazetarët. Megjithatë, gazetarët të cilët merren me gazetari hulumtuese theksojnë se "për dallim prej më parë, zyrtarët e Agjencisë tregojnë shumë më tepër mirëkuptim dhe u ofrojnë gazetarëve ndihmë gjatë përdorimit të ligjit<sup>37</sup>.

A janë autoritetet në përgjithësi transparente?

A sigurojnë marrëdhënie të hapura, jodiskriminuese dhe të drejta me mediat apo preferojnë të punojnë në fshehtësi?

A kanë institucionet shtetërore trajtim të privilegjuar për mediat që anojnë politikisht?

Edhe gjatë vitit 2022 perceptimi i përgjithshëm i më shumë ekspertëve, gazetarëve dhe organizatave është se gjendja me transparencën e institucioneve është përmirësuar në krahasim me periudhën para vitit 2016. Megjithatë, anketat e veçanta të sektorit civil tregojnë se disa institucione shtetërore nuk janë mjaft transparente dhe në veçanti është e ulët e ashtuquajtura transparencë aktive te institucionet në nivel lokal<sup>38</sup>.

Në drejtim të përgjigjeve më konkrete të këtyre pyetjeve, për nevojat e këtij raporti janë realizuar intervista me gazetarë ku është theksuar se në vitin e fundit vërehet një trend i shmangies apo mosdhënies së përgjigjeve konkrete nga përfaqësues të institucioneve të caktuara publike ndaj pyetjeve gazetareske. Me pakënaqësinë e qasjes deri te informacionet me interes publik, gazetarët dhe punonjësit e mediave shkojnë në gjendje të vetë-censurimit .

Sa janë të hapura Qeveria dhe Ministrinë për publikun?

Në kontaktet e drejtpërdrejta me gazetarët gjatë vitit të kaluar, si dhe nga intervistat e realizuara me disa gazetarë për qëllimet e këtij hulumtimi, ata përgjithësisht vlerësojnë se transparenca në vitin 2022 është përmirësuar në krahasim nga vitet e kaluara por shqetësues mbetet trendi i shmangies, gjegjësisht mos ofrimi i përgjigjeve konkrete nga ana e disa institucioneve. Vlerësohet se transparenca e Qeverisë së RVM-së është përmirësuar në raport me institucionet e tjera shtetërore por shfaqet një situatë e re, kur gjatë konferencave për shtyp drejt institucioneve të caktuara publike në pyetjet e parashtruara të gazetarëve të shmangen përgjigjet ose fare mos të jepen. Rast i tillë për të cilin SHGM ka reaguar<sup>39</sup> publikisht është ngjarja kur sekretari i përgjithshëm i Qytetit të Shkupit, Gligorov, në fjalimin e tij para ekipeve gazetareske dha një deklaratë të shkurtër me të cilën akuzoi transportuesit privatë për bllokadë politike të qytetit dhe në fund nuk dëshoi

35 Sipas Raportit të punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në vitin 2021, janë paraqitur vetëm 8 raporte nga denonuesit për dyshime apo njohuri për sjellje të paligjshme apo të paligjshme në institucione të ndryshme. Qasur më: 26.12.2022. <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2021/12/DKSK-Infografik-2021-01-scaled.jpg>

36 Për nevojat të këtij raporti është realizuar intervistë me gazetarin Bojan Stojanovski nga Laboratori i Reporterëve Hulumtues (IRL), 23.12.2022.

37 Ibid.

38 Fondacioni për Internet dhe Shoqëri Metamorfozis, Indeksi i qasjes së hapur të Pushtetit Lokal 2022. Qasur më 26.12.2022. [https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti\\_arhiva/objaven-indeks-na-otvorenost-na-lokalnata-samouprava-za-2022-godina/](https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti_arhiva/objaven-indeks-na-otvorenost-na-lokalnata-samouprava-za-2022-godina/)

39 Njoftimi i SHGM-së, "Funksionarët duhet të përgjigjen në pyetjet e gazetarëve", 7.12.2022, Qasur më 28.12.2022. <https://bit.ly/3PZKCCc>

t'u përgjigjet pyetjeve të gazetarëve me arsyetimin se kishte obligime tjera.

### A janë transparente gjykatat? A kanë mediat qasje në proceset gjyqësore pa diskriminim dhe pa kufizime të panevojshme?

Në kuadër të aktiviteteve të SHGM-së në vitin 2022 është përgatitur një anketë për qëndrimet dhe perceptimet e gazetarëve për transparencën e gjyqësorit në Maqedoninë e Veriut. Sipas rezultateve të marra nga hulumtimi<sup>40</sup>, vërehet se gjyqësori është më i hapur dhe më transparent se para pesë viteve por kjo nuk mjafton. Gjithashtu vihet re se këto lëvizje në drejtim pozitiv nuk janë si rezultat i përmirësimit sistematik, të strategjisë së miratuar apo zbatimit të reformës në kuptim të rritjes së transparencës dhe publikimit të gjyqësorit, por përkundrazi vijnë si rezultat i vendimeve personale të individëve të caktuar me qëllim që të rritet shkalla e transparencës në punën e institucioneve të cilat i përfaqësojnë. Rezultatet e hulumtimit gjithashtu tregojnë se më shumë vëmendje i kushtohet mundësitë të transparencës formale sesa përmbajtjesore në gjyqësor. Cilësia e kuadrit aktual gjyqësor nuk kontribuon mjaftueshëm në transparencën dhe hapjen optimale të sektorit të drejtësisë. Me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë së Maqedonisë së Veriut, në mars të vitit 2021, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) ka dorëzuar propozim për ndryshime në Rregulloren e Gjykatës<sup>41</sup> i cili është i rëndësishëm për punën e papenguar të gazetarëve informimin në kohë dhe të saktë të publikut për punën e gjykatave. Paraprakisht për propozimin janë bërë konsultime me gjyqtarë dhe përfaqësues të kësaj ministrie si dhe gazetarët që raportojnë për punën e gjykatave. Ndryshimet e propozuara i referohen transparencës së punës së gjykatave, aksesit të gazetarëve në procesverbalet dhe seancat gjyqësore si dhe përmirësimin e cilësisë së informacioneve të publikuar në faqet e internetit të gjykatave. SHGM theksoi nevojën për krijimin e një regjistri të zëdhënësve të institucioneve gjyqësore i cili duhet të ishte publikisht i disponueshëm në ueb faqet e gjykatave dhe në ueb faqen [www.sud.mk](http://www.sud.mk).

Sipas informacioneve gjatë komunikimit me gazetarët, gjykatat në Shkup gjatë vitit të kaluar kanë dukshëm më shumë transparencë në krahasim me gjykatat brenda vendit.

### A është siguruar akses i publikut në seancat parlamentare? A ekzistojnë kufizime për gazetarët në ndekjen e punës së Parlamentit?

Gazetarët që raportojnë nga Kuvendi nuk janë të informuar plotësisht dhe objektivisht nga koordinorët e grupeve parlamentare të cilët nuk kanë krijuar një praktikë të informimit të rregullt të gazetarëve për realizimin e aktiviteteve të planifikuara, veçanërisht për marrëveshjet mes pushtetit dhe opozitës apo ndërmjet kryetarit të Kuvendit dhe një grupi të caktuar parlamentar. Një gazetarë që ndjek këtë çështje, në një intervistë për qëllimet e këtij raporti, vlerësoi se situata me transparencën e Kuvendit është përmirësuar por ka ende shumë detaje që duhen trajtuar për arritjen e një komunikimi efikas dhe efektiv me koordinorët e grupeve parlamentare në Kuvendin e interes të publikut<sup>42</sup>. Perceptimi i përgjithshëm tek gazetarët është se gjatë viteve të fundit Kuvendi ka qenë më transparent se më parë edhe pse shpesh ndodh që marrja e përgjigjeve të kërkuara të vonohet. Kryetari i Kuvendit vazhdoi të mbajë takime të rregullta me gazetarë me qëllim që ata ti mbajë të përditësuar me punën e legjislativit dhe planet e tij të punës. Por gazetarët dhe publiku informohen atëherë kur deputetët vendosin që “zënkat politike” të bëhen publike dhe kur vendosin të organizojnë konferenca për shtyp<sup>43</sup>.

40 SHGM, “Qëndrimet dhe perceptimet e gazetarëve për transparencën e gjyqësorit në Maqedoninë e Veriut”, Shkup: 2021, Qasur më 18.12.2022. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/09/Studija-10.pdf>

41 SHGM, “SHGM me propozime konstruktive për përmirësimin e Rregullores së Gjykatës”, 28.11.2022. Qasur më: 28.11.2022. <https://bit.ly/36QyOA6>

42 Për përgatitjen e këtij raporti, më datë 23.12.2022 është realizuar intervista me gazetaren Almedina Ismaili nga TV21.

43 SHGM, “Transparenca e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë pandemisë me virusin korona”, shtator, 2021. Qasur më: 18.11.2022. <https://bit.ly/3tV9zFM>

### **B1 Kufizimet ekonomike në punën e gazetarisë**

**Sa gazetarë kanë nënshkruar kontrata pune? A kanë ata mbrojtje adekuate sociale? Sa janë të larta pagat e gazetarëve? A paguhen rregullisht?**

Sipas hulumtimit të fundit të SPGPM-së, gazetarët e rinj dhe ata që janë të angazhuar në mediat digjitale në vend më së shpeshti punojnë me kontrata pune të parregulluara. Ky problem po shfaqet gjithnjë e më shumë në sipërfaqe në kushtet e krizës shëndetësore dhe ekonomike gjatë viteve të fundit, sidomos në rastin e sigurimeve shëndetësore. Në vend ende nuk ka të dhëna të sakta se sa gazetarë kanë kontrata pune, por vlerësimi i përgjithshëm është se në mediat private, shumica e gazetarëve kanë kryesisht kontrata me kohë të caktuar ose kontrata mbi vepër. SPGPM-ja në hulumtimin e saj<sup>44</sup> për pozitën ekonomike të gazetarëve dhe punëtorëve të mediave ka konstatuar se 56,1 për qind e gazetarëve të intervistuar janë të punësuar rregullisht me kohë të pacaktuar, 19,1 për qind janë të punësuar me kohë të caktuar, 10,4 për qind punojnë me kontratë mbi vepër. 12,2 për qind janë të angazhuar si honoraristë dhe 0,9 për qind janë deklaruar se punojnë vullnetarisht. Në pyetjen se sa janë të kënaqur me të ardhurat dhe sigurinë ekonomike, më shumë se gjysma e gazetarëve (56.7%) deklaruan se ishin të pakënaqur. Në të njëjtën kohë, 31 për qind janë

<sup>44</sup> SPGPM, "Siguria dhe gjendja socio-ekonomike në media", Shkup: 2022, Qasur më: 23.12.2022. <https://bit.ly/3SuxWRZ>

plotësisht të pakënaqur dhe 25.7 për qind janë kryesisht të pakënaqur. Vetëm 2.7 për qind janë plotësisht të kënaqur dhe 22.4 për qind janë kryesisht të kënaqur. Kjo konfirmon se edhe në vitin 2021, një pjesë e madhe e gazetarëve dhe punonjësve të medias kishin një status pune jashtëzakonisht të pasigurt. Që nga fillimi i pandemisë në vitin 2020, shumica e mediave kanë ulur pagat e gazetarëve dhe punonjësve të medias dhe një numër i madh i gazetarëve gjithashtu ankohen se si në vitet e kaluara nuk po u paguhet sigurimi pensional dhe social<sup>45</sup>. Shumica e gazetarëve kanë të ardhura mujore shumë më të ulëta se paga mesatare në vend e cila në vitin 2021 ishte 28.869 denarë. Por sipas anketës së SPGPM-së<sup>46</sup>, paga e shumicës së gazetarëve të rinj nuk e arrin as këtë shumë. Gjashtë për qind e gazetarëve të rinj të anketuar janë përgjigjur se marrin më pak se 25.000 denarë, madje 27 për qind prej tyre paguhen nga 15.000 denarë deri në 20.000 denarë. Pjesa e tjetër prej 12,9 për qind janë përgjigjur se paga e tyre është nga 25.000 deri në 30.000 denarë, përkatesisht 24.6 për qind se kanë pagë më të madhe se 30.000 denarë. Gjendja në Servisin Publik është disi më e mirë ku paga mesatare e gazetarëve në vitin 2020 ishte 38.120 denarë edhe pse konsiderohet se pagat e gazetarëve, veçanërisht atyre që nuk janë fillestarë, janë më të ulëta se pagat e gazetarëve në televizionet private nacionale<sup>47</sup>.

**Si janë kushtet për punën e gazetarëve?  
Cilat janë problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohen në vendet e tyre të punës?**

Një pjesë e gazetarëve por edhe disa punëtorëve mediatik vazhdojnë të punojnë jashtë orarit të papaguar dhe punojnë pa kompensim edhe gjatë festave dhe fundjavave. Për një pjesë të gazetarëve, puna në kushtet e pandemisë e cila ishte aktuale në vitet e kaluara, ua vështirësoi edhe më shumë kryerjen e detyrave profesionale, veçanërisht atyre që ishin të ekspozuar ndaj situatave stresuese gjatë raportimit nga institucionet shëndetësore dhe spitalet. Për nevojat e këtij raporti është

zhvilluar edhe një intervistë me një gazetar, ku i pyetur për sfidat me të cilat përballen në vendin e punës theksoi se shmangia, gjegjësisht mosdhënia e përgjigjeve në pyetjet e gazetarëve është një problem i madh i cili çon në vet-censurë<sup>48</sup>.

## **B2 Pavarësia redaktoriale në mediat private**

**A kanë miratuar mediat private dokumente organizative që lejojnë redaksitë të jenë të ndara dhe të pavarura nga strukturat e menaxhimit dhe marketingut? A kanë vendosur mediat private rregulla për pavarësinë redaktoriale nga pronarët e mediave dhe organet drejtuese? A respektohen ato rregulla?**

Në mediat më të mëdha është e zakonshme që redaksitë të jenë të ndara nga strukturat drejtuese. Kur bëhet fjalë për mediat më të vogla lokale situata është edhe më komplekse, presionet shprehen ndryshe dhe vijnë si nga pronarët ashtu edhe nga pushtetarët vendas. Nga komunikimi i drejtpërdrejtë me gazetarët gjatë vitit të kaluar mund të konstatohet se rrallë ekzistojnë akte të tilla. Nuk ka të dhëna apo rishikime të publikuara nga të cilat mund të përcaktohet se sa media private kanë akte apo rregulla të brendshme organizative sipas të cilave redaksia formalisht ndahet nga menaxhmenti i medias.

**A kanë miratuar mediat private Kode të brendshme të etikës apo i përmbahen Kodit të përgjithshëm të etikës?**

SHGM nuk ka të dhëna që mediat private kanë krijuar Kode apo rregulla të tyre të veçanta etike. I vetmi Kod që vlen për të gjithë gazetarët profesionistë është Kodi i gazetarëve të Maqedonisë, i miratuar në vitin 2001<sup>49</sup>, i cili është bazë për veprimet e Këshillit të Nderit të SHGM-së dhe Komisionit për ankesa pranë Këshillit për Etikë në Media të Maqedonisë. KEMM së fundmi ka zhvilluar udhëzime për raportim etik të mediave online<sup>50</sup>, përkatesisht udhëzime për aplikimin e Kodit të gazetarëve në sferën online.

45 Realizuar intervistë me një gazetarë për nevojat e këtij hulumtimi Ferikan Ilyazi, Euronews, 23.12.2022.

46 SPGPM, "Anketa: Me pagë nën mesataren, gjysma e gazetarëve të rinj duan të largohen nga profesioni", Shkup: 2021. Qasur më 21.12.2022 <https://bit.ly/3K9EIQH>

47 Një kategori veçanërisht e rrezikuar e gazetarëve janë korrespondentët e RTM-së, të cilët janë më të pakët në numër dhe kryesisht kanë kontrata për angazhim të përkohshëm, të cilat lehtë mund të ndërpriten. Në nëntor të vitit 2019 u publikua një njoftim për punësimin e dhjetë korrespondentëve të pavarur, që është progres për RTM-në, megjithëse SHGM mbron një model tjetër i cili do të zgjidhte në mënyrë sistematike dhe të përhershme situatën e kësaj kategorie gazetarësh. Shih më shumë: SHGM "Dokument për politikën publike: Statusi dhe nevoja e korrespondentëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut", Shkup: 2019. Qasur më: 14.12.2022. <https://bit.ly/3eI0YND>

48 Intervistë me gazetaren Miroslava Burns për qëllimet e këtij raporti e realizuar më datë 23.12.2022

49 SHGM "Kodi i Gazetarëve të Maqedonisë": <https://znm.org.mk/kodeks-na-novinarite-na-makedonija/>

50 KEMM, "Udhëzues për raportim etik të mediave online - Aplikimi i Kodit të gazetarëve në sferën online", Shkup: 2020. Qasur më: 26.11.2022. <https://bit.ly/2RRdYZP>

Cilat janë format më të zakonshme të presionit nga pronarët dhe drejtuesit e mediave mbi redaksitë apo gazetarët? Cili ishte shembulli më ilustrues i presionit të pronarëve apo drejtuesve të mediave ndaj një redaksie apo gazetari gjatë vitit të kaluar?

---

Gjatë viti të kaluar nuk ka pasur asnjë çështje të hapur gjyqësore ku një gazetar të ketë paditur një person drejtues për mobing dhe gjithashtu nuk ka pasur një vendim përfundimtar për një akt të tillë. Nga ana tjetër, lidhja mes pronarëve të mediave të caktuara dhe qendrave të pushtetit është shpesh në dëm të gazetarëve që punojnë në këto media. SHGM nuk ka njohuri konkrete për presion të ushtruar nga menaxhmenti ndaj gazetarëve gjatë vitit 2022, por fakt është se gazetarët rrallë raportojnë raste të tilla. Presionet zakonisht nuk shprehen si kërcënime të drejtpërdrejta. Gazetarët nuk i padisin redaktorët dhe pronarët e mediave kur u shkelen të drejtat e tyre.

### **B3 Pavarësia redaktuese në radiodifuzerin publik**

---

A ka miratuar Servisi publik radiodifuziv Kod për sjelljen e gazetarëve dhe pavarësinë redaktuese? A i përmbahen gazetarët këtij Kodi?

---

Servisi publik e miratoi Kodin e Etikës për Gazetarët<sup>51</sup> që nga viti 2017 i cili vlen për stafin dhe të gjithë punonjësit e RTM-së. Kodi, i cili ka gati gjashtë vite është në fuqi, është kritikuar që në fillim nga komuniteti gazetaresk për shkak të përmbajtjes së dokumentit, por edhe për mungesë transparence në përgatitjen e tij. Mangësia më e madhe e Kodit është përzierja e etikës gazetareske me disiplinën e punës dhe me të drejtat dhe detyrimet e gazetarëve që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës. Komisioni i Etikës në RTM, i cili është përgjegjës për monitorimin e respektimit të Kodit, nuk ka pranuar asnjë ankesë në periudhën e kaluar. Në vitin 2021, SHGM-ja kërkoi ndryshimin e Kodit të Etikës së RTM-së dhe përcaktimin e procedurave për paraqitjen e peticioneve dhe për mënyrën e punës së Komisionit të Etikës, i cili do të publikohej në ueb faqen e RTM-së. Edhe pse nga komunikimi me drejtuesit e RTM-së përgjithësisht ka një disponim për ndryshimin e këtij Kodi, në vitin 2022 nuk kishte aktivitetet specifike për këtë temë. Në nëntor të vitit 2022, SHGM dhe RTM nënsh-

kruan Memorandum për bashkëpunim, me të cilin të dyja palët u angazhuan që në vitet e ardhshme të realizojnë trajnime të përhershme për profesionalizim dhe avancimin e vazhdueshëm të standardeve në punën e punëtorëve të Televizionit të Maqedonisë, si parakusht për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë së përmbajtjeve, përmirësimin e standardeve etike por edhe ngritjen e kapaciteteve të RTM-së.

**A kanë vendosur organet e servisit publik radiodifuziv rregulla të brendshme organizative për të mbrojtur pavarësinë e redaksive nga ndikimi i organeve drejtuese? A respektohen ato rregulla?**

---

Sikur edhe gjatë viteve të kaluara, edhe për vitin 2022 mund të thuhet se nuk janë bërë ndryshimet e pritshme thelbësore në strukturën e brendshme të Servisit Publik, të cilat supozohej të ishin pjesë e procesit të reformës së medias. RTM-ja ka miratuar aktet e saj të brendshme organizative sipas të cilave redaksia formalisht është e ndarë nga strukturat drejtuese. Megjithatë, në faqen e internetit të Radio-Televizionit të Maqedonisë është e vështirë të gjejmë informacione për rregullat e organizimit të brendshëm dhe për funksionimin e organeve dhe trupave të tij.

Cilat janë format më të shpeshta të presionit që i aplikon pushteti ndaj redaksive apo gazetarëve individualë në Servisin Publik?

---

Në kërkesat për reforma në media është theksuar vazhdimisht se nevojitet departizim i Servisit Publik, zgjedhja e një Këshilli të ri Programor të pavarur dhe organeve të reja drejtuese. Edhe gjatë vitit të kaluar 2022, ndryshime të tilla në drejtim të zgjedhjes së një Këshilli të ri Programor nuk ndodhi. Mjetet për financimin e vepërtimisë radiodifuzive, për funksionimin dhe zhvillimin e RTM, Ndërmarrjes publike Radiodifuzioni i Maqedonisë dhe ASHMAA sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në shumë prej 0,8 për qind. deri në 1 për qind nga të ardhurat totale të realizuara në vitin para vitit fiskal për të cilin është përcaktuar shuma. Mjetet janë të ndara si vijon: 74,5 për qind për RTM-në për mbulimin e shpenzimeve për prodhimin dhe transmetimin e programeve dhe për zhvillimin tekniko-teknologjik, 19,5 për qind për Radiodifuzionin e Maqedonisë për mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe zhvillimin e rrjetit publik radiodifuziv dhe 6 për qind për ASHMAA. Burim shtesë i financimit të RTM-së janë donacionet, shitja e programeve dhe shërbimeve si dhe fonde të tjera.

---

<sup>51</sup> MRT, "Kodi i etikës së MRT-së për gazetarët, stafin krijues dhe të gjithë punonjësit e RTM-së", Shkup: 2017. Oasur më: 12.12.2022. <https://bit.ly/3uL6Z2C>

## B4 Pavarësia redaktoriale në sektorin jofitimprurës

A kanë miratuar mediat nga sektori jofitimprurës një kod për sjellje për gazetarët dhe pavarësinë redaktoriale?  
A l përmbahen gazetarët këtij Kodi?

Disa nga mediat informative jofitimprurëse në internet janë të regjistruara si Shoqata Qytetare dhe deri më tani nuk është bërë asnjë analizë gjithëpërfshirëse për punën e tyre dhe për statusin dhe pavarësisë së gazetarëve në to. Disa media online që financohen kryesisht ose tërësisht nga donatorë dhe merren me gazetari investigative si dhe në një online radio që ka përmbajtje për të rinjtë, i përkasin grupit të mediave online jofitimprurëse. Media jofitimprurëse janë edhe tri radiot studentore që funksionojnë në kuadër të tri universiteteve shtetërore (Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, Universiteti “Shën Klimenti i Ohrit” në Manastir dhe Universiteti “Goce Dellçev” në Shtip), si dhe një radio fetare në Strumicë. Redaksia e këtyre mediave është e vogël dhe ka pak gazetarë të cilët punojnë çdo ditë dhe financimi i tyre është jo stabil dhe i paqëndrueshëm. Nuk ka një Kod të veçantë për sjelljen e gazetarëve në sektorin jofitimprurës, por në dhjetor të vitit 2020, KEMM miratoi udhëzime për raportimin etik në mediat online<sup>52</sup>, të cilat në fakt shtjellojnë zbatimin e parimeve etike bazë të Kodit të gazetarëve në sferën online. Gjithashtu, KEMM dhe SHGM formuan Regjistrin e mediave profesionale online<sup>53</sup>, në të cilin tashmë këtë vit janë anëtarë 154 media informative online, përfshirë ato jofitimprurëse. Pjesa dërmuese e këtyre mediave kanë pranuar ose sillen sipas Kodit të Etikës dhe sipas Udhëzimeve për Raportimin Etik në Mediat Online, për zbatimin e të cilave përkujdeset KEMM.

Cilat janë format më të zakonshme të presionit ndaj mediave në sektorin jofitimprurës?  
Cili është shembulli më ilustrues i presionit mbi mediat në sektorin jofitimprurës?

Ndonëse presioni ndaj mediave jofitimprurëse, disa prej të cilave merren me gazetari hulumtuese, ka rënë në krahasim me periudhën deri në vitin 2016, kur gazetarët dhe redaktorët e këtyre mediave shpeshherë diskreditohehin dhe sulmoheshin ashpër në publik për shkak të shkrimeve kritike kundër Qeverisë së asaj kohe dhe njerëzve të fuqishëm, perceptimi është se gjatë dy viteve të fundit ajo është rritur. Një shembull i pre-

sionit ndaj mediave jofitimprurëse gjatë vitit të kaluar është rasti i Laboratorit të Reporterëve Hulumtues<sup>54</sup> që u kërcënua me padi nga pronari i klinikës private “Zhan Mitrev”, pas transmetimit të storjes që përmendte përfshirjen e tij në keqpërdorimin e qytetarëve të Maqedonisë gjatë krizës shëndetësore, duke përdorur metoda mjekësore të pa miratuara nga autoritetet në vend. Procedurat gjyqësore për këtë rast ende vazhdojnë në Gjykatën Penale të Maqedonisë së Veriut. Padi të tilla njihen si padi për të parandaluar pjesëmarrjen strategjike në publik (SLAPP) dhe kanë për qëllim të frikësojnë dhe ti lodhin financiarisht gazetarët ose organet e mediave të paditura. Kur ato iniciohen nga politikanë dhe bartës të funksioneve publike ose nga persona të cilët me statusin e tyre në shoqëri mund të ndikojnë në rrjedhën e procedurës si dhe në rezultatit e saj, këto padi mund të shkaktojnë frikë dhe auto-censurë te gazetarët dhe rrjedhimisht shkeljen e të drejtës së qytetarëve për t’u informuar. Vitin e kaluar SHGM ka regjistruar pesë raste të padive të tilla SLAPP kundër IRL për historitë hulumtuese.

## B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve

Sa liri kanë gazetarët në përzgjedhjen e storjeve gazetareske me të cilat do të punojnë dhe në vendosjen se cilat aspekte të një storjeje duhet të theksohen? Sa shpesh marrin pjesë gazetarët në redaktimin dhe koordinimin e politikave redaktuese?

Sipas deklaratave të bashkëbiseduesve në intervistat e realizuara për qëllimet të këtij raporti, shumica e gazetarëve gjatë vitit 2022 kanë pasur liri në përzgjedhjen e temave për të cilat do të raportojnë<sup>55</sup>. Megjithatë, përzgjedhja e temave për raportim në mediat rajonale dhe lokale është një problem më i madh për gazetarët për shkak të mjedisit të vogël në të cilin operojnë këto media, për shkak të lidhjeve klienteliste të krijuara të pronarëve me kryetarët e komunave dhe pushtetarët e tjerë vendorë si dhe për shkak të gjendjes së keqe financiare në të cilën ndodhen këto media. Kohëve të fundit është folur haptas për ndikimin e disa redaktorëve tek gazetarët, duke theksuar se ndikimi në punën e përditshme nuk është aq i dukshëm, pra se ka më shumë auto-censurë sesa presion të drejtpërdrejtë.

52 KEMM, “Udhëzime për Raportimin Etik në Mediat Online”. Qasur më: 9.11.2022. <https://bit.ly/3tg60bx>  
53 Regjistri i mediave profesionale online në Republikën e Maqedonisë së Veriut <https://promedia.mk/>

54 IRL, “Gjaku i papastër”, 17.10.2022. Qasur më: 10.12.2022 <https://bit.ly/3Vg377n>

55 Për qëllime të këtij hulumtimi, më 23.12.2022 është realizuar intervista me gazetarin Zenel Miftari nga Koha dhe Simona Srbinska nga MPB.



**Cili është perceptimi i vetë gazetarëve për sa i përket ndikimit të tyre nga burime të ndryshme ndikimi? A i nënshtrohen auto-censurës gazetarët për shkak të frikës për humbjen e vendit të punës apo për shkak të presioneve të tjera?**

Perceptimi i cili mbizotëron tek gazetarët është se në redaksi dihet paraprakisht se cilat tema janë të pranueshme, pra cilat tema redaktori do t'i vlerësojë si të shkëlqyera dhe cilat do të refuzohen. Gazetarët dhe punonjësit e mediave thonë se problemi më i madh është fakti që nuk është puna e tyre thelbësore për pronarët e mediave. Më shpesh, në sfondin e mediave ka kompani të tjera të cilat nga ana tjetër janë të lidhura me tenderë me ministri dhe institucione dhe nga ky aspekt ka tema tabu për media të caktuara. Një situatë e tillë është veçanërisht e theksuar në mediat lokale. Në këtë kontekst, gjatë një interviste të zhvilluar me një gazetarë për qëllimet e këtij raporti, u theksua se vitin e fundit, një faktor që kontribuon në censurimin e gazetarëve në tekstet e tyre është mospërgjigja e pyetjeve gazetareske nga ana e institucioneve në shtet. Shembull klasik i shmangies nga përgjigjet e pyetjeve gazetareske ishte këshilltari në Komunën e Ohrit, Nefi Useini, i cila në pyetjet e parashtruara nga një gazetarë përmes telefonit u përgjigj me ofendime dhe sharje të vrazhda dhe përveç kësaj nuk iu përgjigj pyetjeve gazetareske që janë me interes publik<sup>56</sup>. Kjo sjellje e papërshtatshme dhe për të thënë më së paku agresive e zyrtarëve publikë të vetëqeverisjes lokale në vend, sjell frikë dhe auto-censurë te gazetarët dhe punonjësit e mediave në vend.

## **B6 Pozita ekonomike e gazetarëve**

**A punojnë gazetarët në kushte më të këqija pune në krahasim me kolegët e tyre gazetarë? A nënshkruajnë kontrata pune aq shpesh sa gazetarët?**

SHGM dhe SPGPM nuk kanë regjistruar gjatë vitit të kaluar nga gazetarët ndonjë rast të raportimit për diskriminim në vendin e tyre të punës. Vlerësimi i përgjithshëm është se pozicioni i gazetarëve në redaksi nuk ndryshon shumë nga pozicioni i gazetarëve. Pavarësisht numrit shumë të vogël të gazetarëve që kanë nënshkruar kontrata pune, konsiderohet se punëdhënësit, në përgjithësi kur bëhet fjalë për gazetarët gra të punësuar

<sup>56</sup> Njoftim i SHGM-së, "SHGM dhe SPGPM dënojnë ashpër fyerjet e këshilltarit në komunën e Ohrit Nefi Useini ndaj kolegës Emilija Misirievski", 28.6.2022, Qasur më: 18.12.2022. <https://bit.ly/3GU6ACK>

ara për një kohë të pacaktuar, respektojnë të drejtat elementare të përcaktuara me ligj, siç është pagesa e pagave, pushimi i lehonisë dhe pushimet me pagesë. Megjithatë, është fakt se diskriminimi gjinor dhe pozita jo e favorshme e grave krahasuar me atë të burrave në vendin e punës shpeshherë nuk njihet nga vetë gazetarët.

**A janë gratë në pozicione drejtuese në redaksi njësoj si burrat?**

Sipas indikacioneve të gazetarëve dhe punonjësve të medias gjatë vitit të kaluar, në përgjithësi, mundësitë e grave për t'u zhvilluar si gazetarë profesionale dhe për tu avancuar në karrierë nuk janë shumë më të ulëta në krahasim me mundësitë e kolegëve të tyre gazetarë. Sipas analizës së rregullatorit ASHMAA<sup>57</sup>, numri i përgjithshëm i të punësuarve në industri në fund të vitit 2021 ishte 2,449 persona, shumica e të punësuarve në televizionet komerciale ishin burra, pra të punësuar ishin 365 burra më shumë se gra dhe gjithsej nga 2,449 persona ishin të punësuar në të gjithë industrinë. Në Servisin Publik punonin 685 persona, në televizionet private 1377 persona dhe në radio stacionet komerciale 387 persona. Nga personat e punësuar në marrëdhënie të rregullta pune, pjesa më e madhe kanë qenë me arsim të lartë, 329 persona. Prej tyre gjysma ishin gazetarë (165 persona). Gjithsej 266 persona kishin arsim të mesëm, nga të cilët 115 persona ishin të punësuar si zbatues. Në anën tjetër, ka media si MIA (Agjencia për Informim të Mediave) dhe IRL, ku "gratë janë në numër më shumë se kolegët e tyre gazetarë dhe ato gjithashu kanë një rol të rëndësishëm udhëheqës në redaksi".

**Sa janë pagat e tyre në krahasim me pagat e kolegëve gazetarë? A vuajnë presione specifike me bazë gjinore në redaksi dhe jashtë tyre gazetarët?**

Për faktin se në vitin 2022 nuk ka asnjë analizë që do të mund të siguronte informacione të qarta dhe të sakta, sipas të dhënave me të cilat disponon SHGM, në vitin 2021, shumica e gazetarëve dhe punëtorëve mediatikë kanë marrë paga prej 15.000 deri në 20.000 denarë. Sipas analizës së fundit të publikuar nga SPGPM<sup>58</sup>, paga mesatare neto e gazetarëve në dy vitet e fundit ishte 350 euro. Kjo do të thotë se 70 për qind e gazetarëve në Maqedoni marrin pagë mujore nën mesataren. Sipas

<sup>57</sup> ASHMAA, "Struktura e të punësuarve në industrinë mediatike audio dhe audiovizuale në vitin 2021", Shkup:2022, Qasur më: 13.11.2022. <https://aymu.mk/wp-content/uploads/2022/09/Struktura-na-vrbotenite-vo-audio-i-diovizuelinata-mediumska-industrija-vo-2021-godina.pdf>

<sup>58</sup> SPGPM-së, "Gazetarët dhe punëtorët mediatikë me paga shumë nën mesataren", Shkup: 2020. Qasur më: 12.12.2022. <https://bit.ly/3tltpkd>

të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave<sup>59</sup>, paga mesatare mujore neto e paguar për punëtor, në nëntor të vitit 2021 ishte 29.130 denarë. Pagat e gazetarëve ndryshojnë në varësi të pozitës së gazetarit dhe nuk ka dallim nëse janë burra apo gra.

Në rastet e raportimit për tema të ndjeshme, gazetaret pësojnë fyerje dhe nënçmime të cilat prekin reputacionin e tyre personal dhe profesional, me kualifikime që i referohen vetëm grave, në kuptimin pejorativ, bazuar në paragjykime dhe stereotipa gjinore. Bëhet fjalë për një fenomen që ndikon në mënyrë indirekte në të ardhmen e tyre profesionale dhe jetën private. Ngacmimet në internet, kërcënimet dhe presionet mendohet se u ndodhin më shpesh grave.

Megjithëse nuk ka të dhëna të sakta statistikore nëse gazetaret dhe punonjëset e mediave janë më të ekspozuara ndaj sulmeve, presioneve, ngacmimeve dhe shantazheve, duket se mjedisi ynë është ende i tillë që gazetaret mund të pësojnë ofendime më të mëdha në krahasim me kolegët e tyre, vetëm për shkak të faktit se janë gra. Me komente dhe/ose mesazhe, më rrallë kritikohen rezultatet e tyre profesionale në krahasim me pamjen fizike, jetën private etj<sup>60</sup>. Më shpesh, ky lloj i problemit ndërlihet me rolet gjinore patriarkale të ngujuara në shoqëri por edhe me mungesën e rregullave të qarta, procedurave, akteve të brendshme në vetë mediat, të cilat do të hapnin rrugë dhe do të vendosin udhëzime për garantimin e barazisë gjinore.

---

59 Enti Shtetëror i Statistikave, "Njoftim: Paga neto mesatare mujore e paguar për punëtor, janar 2022". Qasur më: 12.12.2022. <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?rbtxt=40>

---

60 SHGM-së, "Siguria e gazetarëve dhe punonjësve të mediave - realitet ose kërcënim i vazhdueshëm", Shkup:2022, Qasur më: 12.12.2022. <https://bit.ly/3j52Nut>



## C1 Statistikat mbi sigurinë dhe mos ndëshkimin

Sipas regjistrit të SHGM-së, që nga fillimi i vitit 2022 janë regjistruar gjithsej 7 sulme dhe kërcënime të ashpra ndaj gazetarëve<sup>61</sup>. Këtë vit po shohim një rritje të përsëritur të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias krahasuar me vitin e kaluar kur u regjistruan gjithsej 5 sulme. Por gazetarët dhe punonjësit e mediave ndihen ende të pasigurt për shkak të mosveprimit të Prokurorisë dhe Gjyqësorit në zgjidhjen e rasteve të sulmeve të kaluara. Kur Prokuroria do të qëndroj pas të drejtave të gazetarëve në terma afatgjatë, besojmë se numri i incidenteve do të ulet dhe siguria në përgjithësi do të përmirësohet në një nivel tjetër. Kemi nevojë për zgjidhje sistematike që do të garantojnë mbrojtjen afatgjatë të drejtave dhe integritetit të gjithë punëtorëve të mediave në vend. Fakti që numri i sulmeve është rritur, tregon se shkalla e mosndëshkimit, për fat të keq, kur bëhet fjalë për sulmet ndaj punonjësve të mediave në Maqedoni mbetet ende shumë i lartë dhe nuk lë vend për mungesën e shpejtësisë së intervenimeve të institucioneve.

Në periudhën prej vitit 2019-2022, në regjistrin e SHGM-së janë regjistruar gjithsej 30 sulme ndaj gazetarëve dhe punëtorëve të mediave, prej të cilave katër janë regjistruar në vitin 2019, 14 në vitin 2020, pesë në vitin 2021, ndërsa në vitin 2022 janë regjistruar shtatë sulme ndaj gazetarëve dhe punonjësve të mediave. Përsëri edhe në vitin

<sup>61</sup> Nga gjithsej 7 sulme në vitin 2022 të regjistruara në Regjistrin e sulmeve të SHGM-së, për 4 sulme ka një reagim nga rrjeti rajonal [safejournalists.net](https://bit.ly/3QQ6SPm) <https://bit.ly/3QQ6SPm>

2022 vërejmë një rritje të numrit të sulmeve ndaj gazetarëve, ku nga gjithsej 7 sulmet e regjistruara për këtë vit, katër janë sulme fizike dhe ndalime ilegale kundër dëshirës së tyre, ndërsa tre tjerat janë sulme verbale dhe kërcënime<sup>62</sup>. Është karakteristike se numri i sulmeve ndaj gazetarëve është rritur, por edhe i sulmeve fizike. Në 15 vitet e fundit, autoritetet e vendit nuk kanë kryer asnjë hetim për vrasje të një gazetari apo punonjësi të medias.

Në kategorinë e parë të sulmeve - Kërcënimet dhe ngacmimet të cilat nuk lidhen me sigurinë fizike të gazetarëve, përfshin rastin e sulmit verbal ndaj gazetares Maja Jovanovska<sup>63</sup> nga Laboratori Hulumtues i Reporterëve (IRL). Ekipi i IRL-së, pas takimit me disa persona të punësuar në Komunën e Mavrovës dhe NP Parku Nacional Mavrovë, disa herë kanë kontaktuar edhe shefin e Departamentit të Urbanizmit të Komunës, Sadredin Elezosi, i cili ka refuzuar të takohet me gazetarët. Ndonëse, sipas informacioneve të Jovanovskës, pas telefonatës që ajo ka bërë me Sadredin Elezoskin, e cila i ka sqaruar atij se ende janë në pritje të përgjigjeve për pyetjet e dërguara më 4 prill, ai drejton fjalë fyese dhe përçmuese ndaj gazetares duke e kërcënuar me fjalët: “Kujdes nga sot. Do të shihni se çfarë do të ndodhë me ju nëse vini këtu”.

Rasti i dytë ka të bëjë me gazetarët Furkan Saliu dhe Avni Tahiri<sup>64</sup>, të cilëve u janë shkelur rëndë të drejtat e gazetarisë me konfiskimin e pajisjeve dhe ndalimin e paligjshëm kundër vullnetit të tyre. Kjo ngjarje skandaloze ka ndodhur në hapësirat e ndërmarjes publike “Higjiena Komunale – Shkup”. Në këtë ngjarje, një zyrtare femër e cila u paraqit si përgjegjëse për marrëdhëniet me publikun, pas një debati të mëparshëm verbal me dy gazetarët, i mori telefonin kolegut Saliu dhe nuk pranoi t’ia kthente. Njëkohësisht, tre pjesëtarë të sigurimit nga Drejtoria e “Higjienës Komunale – Shkup”, kundër vullnetit të dy gazetarëve, i mbajtën ata në ambientet e këtij institucioni dhe i liruan vetëm pas arritjes së pjesëtarëve të MPB-së, të cilët erdhën pak kohë pas raportimit të mëhershëm të gazetarit Tahiri.

Në kategorinë kërcënime për jetën dhe sigurinë fizike të gazetarëve janë regjistruar dy sulme ndaj gazetarëve. Sulmi i parë i regjistruar përfshin kërcënimin e qartë me vdekje drejtuar gazetarit të TV Klan, Furkan Saliu, nga një profil në Twitter i quajtur “@narco\_girl”. Profili në fjalë në postimin e tij shpreh “Uroj që një plumb endacak i djeshëm të kishte përfunduar në kokën e Furkan Saliut” dhe është thirrje e drejtpërdrejtë për të vrarë gazetar-

in Saliu, duke rrezikuar kështu sigurinë e tij. Sulmi i dytë i regjistruar nga kjo kategori është sulmi ndaj gazetarit Nevri Ademi në shkollën “7 Marsi” në Tetovë. Ai derisa ishte duke pritur për të regjistruar një kronikë me drejtorin e kësaj shkolle, një person i panjohur ia merr celularin dhe ia shtynë mikrofonin. Menjëherë pas kësaj, i njëjti person, duke përdorur gjuhë të vrazhdë tenton ta shtyjë gazetarin jashtë në oborrin e shkollës. Në kategorinë sulme të vërteta ndaj gazetarëve janë regjistruar tre sulme ndaj gazetarëve dhe ekipeve gazetareske, që është një numër dukshëm më i lartë krahasuar me vitin e kaluar. Sulmi në Tetovë kundër ekipit gazetaresk të TV Pollog, i përbërë nga gazetari Nevri Ademi dhe kameramani Zbulim Maksuti, është regjistruar si i pari. Përkatësisht, gjatë incizimit të inserteve për një reportazh nga shkolla fillore “Naim Frashëri” në fshatin Gjurgjevishtë, Komuna Vrapçisht e Gostivarit, gazetari Nevri Ademi dhe kameramani Zbulim Maksuti janë sulmuar verbalisht dhe më pas fizikisht me sëpatë nga një person. Ekipi gazetaresk ka arritur të arratiset dhe ka shkuar menjëherë me makinë në polici për të denoncuar rastin, ndërsa sulmuesi i ka ndjekur me makinë.

Sulmi i dytë i regjistruar nga kjo kategori është sulmi i ndodhur në Manastir, ndaj Zoran Bozhinovskit, pronarit të portalit “Burevesnik”. Sipas deklaratave të tij, ai është sulmuar në orët e vona të natës para shtëpisë së tij nga ana e dy personave të maskuar dhe ka mbetur i lënduar rëndë. Sulmi i fundit i regjistruar në këtë kategori është sulmi ndaj ekipit të TV 24. Ata gjatë xhirimit të një reportazhi, para shtëpisë ku sipas listës zgjedhore jeton Oleksandr Onishchenko, pronari i shtëpisë e ka sulmuar fizikisht kameramanin Ljubisha Ignatov, pasi që fillimisht shau dhe ofendoi ekipin gazetaresk. Trendi i dekurajimit të gazetarëve për raportimin e sulmeve është ende i pranishëm edhe në vitin 2022.

## C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe e aktorëve politikë ndaj mbrojtjes së gazetarëve

### A ekzistojnë dispozita të veçanta në ligje apo mekanizma tjerë të cilët sigurojnë mbrojtjen e gazetarëve, offline dhe online?

Me ndryshimet dhe plotësimet e reja në Kodin Penal, pritet të zgjerohet kompetenca e Prokurorisë për të vepruar sipas detyrës zyrtare për veprat penale që lidhen me sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve dhe të rriten dënimet për sulmuesit<sup>65</sup>. Propozimi nënkupton që

62 Ibid.

63 SHGM, “Dënim i ashpër i kërcënimeve ndaj gazetares të IRL-së”, 3.6.2022, Qasur më 18.12.2022. <https://bit.ly/3BOEMhe>

64 SHGM, “Ngacmohen gazetarë nga nëpunës të Higjienës Komunale – MPB urgjentisht të reagojë”, 8.8.2022, Qasur më 17.12.2022. <https://bit.ly/3PEBqf8>

65 SHGM, “Rritja dramatike e sulmeve ndaj gazetarëve - kërkojmë zgjidhje urgjente”, 2.11.2022. Qasur më: 12.12.2022. <https://bit.ly/3fq9nbG>

Tabela 2. Numri i sulmeve të shënuara ndaj gazetarëve në vitin 2022

Kategoritë	Numri	Përshkrim
<p><b>Kërcënimet dhe maltretimet të cilat nuk kanë të bëjnë me sigurinë fizike të gazetarëve</b></p> <p>Kjo kategori kërcënimesh dhe maltretimesh përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– vëzhgim ose përcjellje;</li> <li>– telefonatat shqetësuese;</li> <li>– ngacimet arbitrare gjyqësore ose administrative;</li> <li>– deklaratat agresive të zyrtarëve publik;</li> <li>– forma tjera të presionit që mund të kërcënojnë sigurinë e gazetarëve gjatë kryerjes së detyrës së tyre;</li> </ul> <p>Këto lloj kërcënimesh nuk përfshijnë mobingun dhe dhunën në mjedisin e punës.</p>	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Sulm verbal dhe fjalë nënçmuese drejtuar gazetares Maja Jovanovska me rastin e kërkesës nga ajo për përgjigje në pyetjet e parashtuara drejtuar shefit të Sektorit për Urbanizëm të Komunës së Rostushë Mavrovë, Sadredin Elezovski.</li> <li>– Punonjësit e Drejtorisë së Higjienës Komunale Shkup, kundër vullnetit të dy gazetarëve Furkan Saliu dhe Avni Tahiri, të cilët i mbajtën në hapësirat e institucionit.</li> </ul>
<p><b>Kërcënime për jetën dhe sigurinë fizike të gazetarëve</b></p> <p>Këto lloje kërcënimesh përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– kërcënime për vrasje të gazetarëve, të miqve të gazetarëve, të familjarëve të tyre ose të burimeve të informacionit;</li> <li>– kërcënime me lëndime fizike të gazetarëve, të miqve të gazetarëve, anëtarëve të familjes së tyre ose të burimeve të informacionit.</li> </ul> <p>Këto kërcënime mund të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– të drejtpërdrejta ose nëpërmjet palëve të treta;</li> <li>– të dërguara në mënyrë elektronike ose drejtpërdrejt ballë për ballë;</li> <li>– implicite, por edhe eksplicite.</li> </ul>	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Kërcënimi eksplicit me vdekje drejtuar gazetarit Furkan Saliu në rrjetin social Twitter.</li> <li>– Në shkollën e mesme “7 Marsi”, gazetari Nevri Ademi, derisa po priste të regjistronte një kronikë me drejtorin e kësaj shkolle, një person i panjohur ia merr celularin dhe ia shtynë mikrofonin. Menjëherë pas kësaj, i njëjti person, duke përdorur gjuhë të vrazhdë, tenton ta shtyjë gazetarin jashtë në oborrin e shkollës.</li> </ul>
<p><b>Sulmet aktuale ndaj gazetarëve</b></p> <p>TLlojet e sulmeve aktuale ndaj gazetarëve mund të përfshijnë lëndimet fizike ose mendore të shkaktuara, rrëmbimet, hyrjet në shtëpi apo zyrë, pajisjet e sekuestruara, ndalimet arbitrare, tentativat për atentat të dështuar, etj..</p>	3	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Sulm fizik me sëpatë ndaj gazetarit Nevri Ademi dhe kameramanit Zbulim Maksuti.</li> <li>– Sulm fizik para shtëpisë së pronarit të portalit nga dy persona të maskuar.</li> <li>– Sulm verbal dhe fizik ndaj kameramanit Ljubisha Ignatov nga ana e Mile.P, pronari i shtëpisë ku jeton Oleksandr Onishchenko</li> </ul>
<p><b>Vrasjet e gazetarëve</b></p> <p>Vrasjet me shkëmbim zjarri, atentatet, vrasjet me shpërthim të bombës, rrahje për vdekje, etj.</p>	0	
<p><b>Kërcënimet dhe sulmet ndaj mediave dhe organizatave gazetareske</b></p>	0	

sulmet, pavarësisht nëse bëhet fjalë për gazetar apo punonjës mediatik,, Prokuroria do ti ndjekë penalisht autorët sipas detyrës zyrtare dhe njëkohësisht autorët do të përballen me një dënim më të lartë burgimi dhe do të ndiqen sipas detyrës zyrtare dhe jo me padi private si më parë (neni 14 i ndryshimeve të propozuara që i referohet nenit 144 të Kodit Penal). Për Prokurorinë Themelore Publike (PTHP) kjo do të jetë rrethanë lehtësuese, pasi do të mund të ndjekë penalisht autorët e sulmeve ndaj gazetarëve në detyrë, si dhe për zyrtarë të tjerë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse gazetarët rrallë vendosin vetë të padisin në rast të një sulmi fizik ose kërcënimi për jetën e tyre për shkak të frikës nga pasojat e kërcënimeve prej aktorëve të sulmeve, si dhe për shkak të kostove të larta financiare që përfshihen në kryerjen e procedurës. Ndryshimet u futën në lexim të parë në Kuvend. Pason leximi i dytë në Komisionin përkatës, ku afati për dorëzimin e amendamenteve është ende në rrjedhë.

Me miratimin e ndryshimeve në Kodin Penal, në rast të rrezikimit të sigurisë gjatë ushtrimit të detyrës gazetareske, pavarësisht nëse bëhet fjalë për gazetar apo punonjës mediatik, Prokuroria do të ndjekë penalisht autorët sipas detyrës zyrtare dhe njëkohësisht edhe autorët do të përballen me dënim më të lartë me burg. Pasi të miratohet kjo, situata do të përmirësohej në plan afatgjatë.

Lidhur me draft tekstin e Kodit Penal aktual, SHGM duke marrë pjesë me përfaqësues të saj në grup punues, ka përgatitur amendamente për Kodin e ri Penal të cili duhet ta votojnë deputetët në Kuvend. Sipas amendamenteve, sulmi ndaj gazetarëve do të konsiderohet sulm ndaj një personi zyrtar. Ato nënkuptojnë zgjidhje sistematike të problemeve që lidhen me sigurinë e gazetarëve në plan afatgjatë. Ministria e Drejtësisë kishte vendim politik për miratimin e ndryshimeve të propozuara nga SHGM-ja dhe Sindikata, që t'i përcjellë ato në Qeveri, ndërsa Qeveria në Kuvend.

Ndryshimet janë dorëzuar në korrik të vitit 2021. Fatkeqësisht, me gjithë lobimet te partitë politike, nuk ka shpresë që propozimet e SHGM-së, pra Kodi i ri Penal, të miratohen brenda një kohe të shkurtër. Megjithatë, SHGM e konsideron si hap pozitiv faktin që Prokuroria po përgatitet të veprojë në mënyrë më efikase në drejtim të mbrojtjes së gazetarëve.

### **A ka mekanizma për monitorimin dhe raportimin e kërcënimeve, ngacmimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve? A publikojnë institucionet shtetërore të dhëna të përditësuara për sulmet ndaj gazetarëve dhe për mosndëshkim?**

Ministria e Punëve të Brendshme ka një Regjistër të brendshëm për sulmet ndaj gazetarëve, por ato të dhëna nuk i nxjerr publikisht, pavarësisht se SHGM-ja vazhdimisht ka treguar një nevojë të tillë. SHGM me iniciativë dhe kërkesë të saj i merr këto të dhëna pasi dërgoi kërkesë direkte në Ministri. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë mban një Regjistër gjithëpërfshirës dhe të detajuar të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve i cili përditësohet rregullisht dhe është i qasshëm publikisht në faqen e internetit të SHGM-së<sup>66</sup>.

### **A ekzistojnë dokumente (protokolle, rregullore etj.) të miratuara nga institucionet shtetërore, të cilat ofrojnë udhëzime për ushtrinë dhe policinë, që ndalojnë maltretimet, frikësimet dhe sulmet fizike ndaj gazetarëve?**

Njësoj si më parë edhe në vitin 2022 ushtria dhe policia nuk kanë miratuar dokumente të brendshme që i udhëzojnë pjesëtarët e tyre se si të sillen ndaj gazetarëve dhe që ndalojnë kërcënimet, frikësimet apo sulmet ndaj gazetarëve.

Në vitin 2022, me iniciativën e SHGM-së u krijua një grup pune, i cili në fillim të vitit 2023 do të promovojë një Protokoll për parandalimin e shkeljes së të drejtave të gazetarëve (veçanërisht gazetarëve) nëpërmjet internetit, të zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe konsultimeve me përfaqësues të mediave/gazetarët dhe punonjësit mediatic, përfaqësues të institucioneve qeveritare përkatëse dhe komunitetit akademik. Grupi punues përbëhet nga anëtarë të SHGM-së, një anëtar i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Fakultetit Juridik dhe Sigurisë në Shkup dhe ekspertë të tjerë të rëndësishëm për hartimin e Protokollit. Qëllimi i protokollit do të jetë krijimi i një mekanizmi funksional për siguri më të madhe dhe parandalimin e shkeljeve të të drejtave

të gazetarëve (veçanërisht gazetarëve) në internet dhe së bashku me ndryshimet në Kodin Penal do të kontribuojë në afirmimin dhe sensibilizimin e mëtejshëm të autoriteteve për çështjen e sigurisë së gazetarëve në hapësirën e internetit në vend. Në dhjetor të vitit 2022, u përgatit një draft version i protokollit i cili u dërgua për mendim në Ministrinë e Punëve të Brendshme. SHGM-ja këtë vit botoi edhe publikimin me titull “Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet gazetarëve dhe organeve policore me qëllim të llogaridhënies dhe transparencës më të madhe”.<sup>67</sup>

### **A bashkëpunojnë institucionet shtetërore me organizatat e gazetarëve për çështjet e tyre të sigurisë? A përmbahen institucionet shtetërore nga miratimi apo promovimi i kërcënimeve ndaj gazetarëve?**

Në mars të vitit 2022, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë dhe zyra e Këshillit të Evropës zhvilluan seminarin me temë “Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet gazetarë(e)ve dhe autoriteteve policore me qëllim të llogaridhënies dhe transparencës më të madhe”, ku morën pjesë gazetarë dhe përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme që punojnë në fushën e marrëdhënieve me publikun. Ky aktivitet i dha mundësinë gazetarëve, anëtarëve të MPB-së dhe aktorëve të tjerë të mediatic për të diskutuar në tema që synojnë thellimin e bashkëpunimit në shkëmbimin e informacioneve me karakter publik. Përfaqësuesit e SHGM-së, së bashku me koordinatoren e qendrës rajonale në Tetovë dhe koordinatoren e seksionit të kameramanëve nga rajoni i Pollogut, realizuan takim me Toni Angelovskin, ndihmës ministër për marrëdhënie me publikun në MPB, ku u morën vesh që do të punonin intensivisht për sfidat aktuale me të cilat përballen kolegët gazetarë dhe kameramanët nga rajoni i Tetovës, me shembuj konkretë, si dhe zgjidhje konstruktive për tejkalimin e tyre. Gjithashtu, temë e diskutimit ishte edhe përmirësimi dhe lehtësimi i kushteve të punës për gazetarët dhe kameramanët gjatë ndjekjes së ngjarjeve të organizuara në rajonin e Tetovës, veçanërisht për ngjarjet që nënkuptojnë vizita zyrtare në qytetin e Tetovës në të cilat ekzistojnë protokolle të veçanta të sigurisë. Angelovski njoftoi se gjatë periudhës së ardhshme do të organizohet takim me udhëheqësit e SPB Tetovë, ku do të ftohen të gjithë punëtorët e interesuar të mediave. Në takim do të diskutohen hapur të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet policisë dhe gazetarëve nga ky rajon.

66 SHGM, “Nevojitet urgjentisht mbrojtje sistematike e punëtorëve mediatic”, Shkup: 2021 Qasur më: 12.12.2022. <https://bit.ly/3Au0yoP>

67 SHGM, “Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet gazetarëve dhe organeve policore me qëllim të llogaridhënies dhe transparencës më të madhe”, Shkup:2022, Qasur më 18.12.2022. [https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/12/MK\\_Podobruvanje-na-sorabotkata-meguii-20601.pdf](https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/12/MK_Podobruvanje-na-sorabotkata-meguii-20601.pdf)

**Në rastet e mbikëqyrjes elektronike, a e respektojnë institucionet shtetërore lirinë e shprehjes dhe privatësinë? Cili është rasti më i fundit i përgjimit elektronik të gazetarëve?**

Pas skandalit të madh të përgjimeve në vend në vitin 2015, kur qindra gazetarë ishin në listën e përgjimeve të policisë sekrete, SHGM nuk ka asnjë njohuri nëse ndonjë gazetar të jetë ekspozuar në mbikëqyrje elektronike nga autoritetet në dy vitet e fundit. Në Gjykatën Themelore Civile – Shkup është paraqitur padi nga 37 gazetarë, në të cilën kërkojnë kompensim për përgjimin e paautorizuar të komunikimeve të tyre në një interval të caktuar kohor. Gazetarët padisin Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjegjësisht Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Agjencinë për Siguri Kombëtare (ASK), si pasardhëse ligjore të ish-Drejtorisë së Sigurisë dhe Kundërzbulimit (DSK), e cila më parë funksiononte në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në kuadër të këtij procesi gjyqësor, paditësit janë në pritje të vendimit të Gjykatës Penale për aktvendim të shkallës së dytë në mënyrë që të vazhdojë procedura civile. Qëndrimi i përfaqësuesve ligjorë të gazetarëve për këtë rast është se pavarësisht nëse dikush do të dënohet gjatë procedimit penal, do të kërkohet dëmshpërbim nga shteti, sepse ai mban përgjegjësi për përgjimin e paautorizuar të gazetarëve. Ata presin që të vërtetohet se ka pasur përgjime të paautorizuara të gazetarëve dhe pastaj të vërtetohet përgjegjësia e shtetit.

### **C3 Sjellja e sistemit gjyqësor civil dhe penal kundër kërcënimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve**

**A ka departamente adekuate brenda gjykatave civile të dedikuara për hetimin dhe ndjekjen penale të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve?**

Gjykata Themelore Civile dhe Penale në Shkup për të pestin vit me radhë, me kërkesë të SHGM-së, ka dorëzuar informacione lidhur me numrin e rasteve në të cilat gazetarët janë palë apo viktimë të sulmeve por nuk është në gjendje të japë informacion më të detajuar për fazat e veprimit. Arsyeimi është se sistemi i ri i udhëheqjes së lëndëve (AKMIS) bazohet në kode, jo në emra dhe profesione të palëve. Sipas Gjykatës Themelore Civile në Shkup, numri i rasteve në vitin 2022, përfshirë datën 10 gusht 2022 ka qenë gjithsej pesëdhjetë e katër për veprat e shpifjes dhe ofendimit, në të cilat gazetarë, punonjësi i medias apo mediumi paraqitet si palë.

**A ndanë Prokurori Publik apo Ministria e Brendshme burime adekuate për zbatimin e hetimeve që kanë të bëjnë me aktet e dhunës ndaj gazetarëve?**

Në maj të këtij viti, kryetari i SHGM-së, së bashku me drejtorin e SHGM-së, Dragan Sekulovski, kanë zhvilluar takim me kryetarin e Prokurorisë Publike në Shkup, Gavril Bubevski, gjatë të cilit është theksuar se themelimi i një departamenti të ri në kuadër të Prokurorisë Publike është e rëndësishme së veçantë dhe e njëjta do të jetë e ngarkuar vetëm për trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve të medias, sigurinë e tyre, si dhe gjuhën e shprehur të urrejtjes ndaj tyre. Kreu i Prokurorisë së Shkupit, Gavril Bubevski, u shpreh i kënaqur që këto propozime konstruktive nga shoqatat esnafë janë të pranueshme dhe si institucion në të ardhmen do të mundohen t'i përgjigjen pozitivisht kërkesave të SHGM-së.

Në shtator të vitit 2022, Prokuroria Themelore Publike caktoi prokuroren Iskra Haxhi Vasileva për Prokurorë kompetente e cila do të monitorojë procedurat në lëndët ku gazetarët janë të sulmuar, dëmtuar, si dëshmitarë ose raportohen në lidhje me kryerjen e detyrave të tyre të punës. Bëhet fjalë për një linjë të hapur në Prokurorinë Publike në të cilën gazetarët mund ta kërkojnë Haxhi Vasilevën, në lidhje me procedurat për sulme fizike dhe dhunë, si dhe për kërcënimet serioze për jetë në Twitter, Facebook, WhatsApp apo në e-mail. Tendanca e Prokurorisë Publike të RMV-së është që pas ri ekipimit të prokurorive të caktojë Prokurorë për mbrojtjen e gazetarëve në qytetet tjera të vendit.

Sipas të dhënave të dorëzuara nga Prokuroria Publike në Shoqatë, nga viti 2014 e deri më sot, janë regjistruar 24 sulme fizike më serioze ndaj gazetarëve dhe vetëm 4 janë zgjidhur me aktgjykim të prerë në favor të gazetarëve, në dëm të sulumësve. Numri nuk është aq i madh sa ishte në 2016 dhe 2017, por në tre vitet e fundit tendenca është se shumica e kërcënimeve ndaj jetës së gazetarëve ndodhin online, por ka edhe sulme fizike.

Në listë janë 79 incidente të rënda për shkeljen e të drejtave të gazetarëve dhe jo vetëm për kërcënime ndaj sigurisë dhe jetës së gazetarëve, por edhe për shkelje të tjera të rënda të të drejtave të tyre. Kërcënimet dhe format më të buta të presionit nga zyrtarë publikë, politikanë, biznesmenë janë të shumta dhe po aq shqetësuese. Nga Prokuroria kërkohet të zbardhen sa më shpejt dhe sa më shumë hetimet e papërfunduara, duke marrë parasysh faktin se mosinteresimi i deritanishëm ka ndaluar shumicën e gazetarëve të raportojnë kërcënimet dhe sulmet ndaj tyre.

Më 2 Nëntor - Ditën Ndërkombëtare për ndërprerjen e mosndëshkimit të krimeve kundër gazetarëve, SHGM së bashku me SPGPM mbajtën një konferencë për media para Kuvendit të RMV-së, në të cilën kërkuan nga partitë politike që menjëherë të miratojnë ndryshimet në Kodin Penal, të cilat janë me status të pazgjidhur në Kuvend tashmë një vit e gjysmë, me të cilat do të rritet siguria e gazetarëve dhe punonjësve të medias.

**A sigurohen masa adekuate për mbrojtjen e gazetarëve në rastet kur është e nevojshme, si përgjigje e kërcënimeve të mundshme për sigurinë e tyre fizike?**

Gazetarët edhe pse përballen me frikë, përgjithësisht nuk duan të kenë siguri fizike sepse kjo mund të ndikojë në punën e tyre të lirë dhe sigurimin e informacioneve të reja. SHGM edhe gjatë këtij viti nuk ka regjistruar asnjë rast të sigurimit fizik nga MPB për gazetarë individual.

**A janë hetimet që përfshijnë frikësim dhe kërcënime për krimet kundër gazetarëve, në kohë, të pavarura dhe efikase?**

Te gazetarët vazhdon të ekzistojë perceptimi se kur bëhet fjalë për rastet në të cilat punonjësit e medias shfaqen si palë, nuk ka interes dhe bashkëpunim të mjaftueshëm ndërmjet institucioneve kompetente si Ministria e Brendshme dhe Prokuroria Publike. Kjo situatë i dekurajon gazetarët të raportojnë sulmet. Këtë perceptim e vërteton edhe fakti ku një numër i madh i rasteve në të cilat janë sulmuar gazetarët akoma është shumë e vështirë që të arrijnë deri të një vendim gjyqësor. Në vitin 2022 janë regjistruar disa sulme më të rënda, pra nga gjithsej shtatë sulme të regjistruara ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias, një është shënuar si shembull pozitiv i zbardhjes së një ngjarjeje penale-juridike. Bëhet fjalë për rastin e Nevri Ademit nga Tetova, i cili u sulmua nga një person me sëpatë dhe sulmuesi i akuzuar tashmë është dënuar nga Gjykata Themelore e Gostivarit.

Kjo situatë sugjeron se duhet qasje më serioze nga ana e institucioneve për zgjidhjen e rasteve, në të cilat si palë paraqitet një gazetar apo punonjës mediati. Përforcimi i bashkëpunimit si dhe proaktiviteti, i institucioneve, janë faktorë të rëndësishëm për rikthimin e besimit ndaj tyre si dhe inkurajim për gazetarët për raportimin e kërcënimeve me të cilat përballen çdo ditë.

Është shumë shqetësues numri i vogël i rasteve plotësisht të përfunduara të sulmeve ndaj gazetarëve dhe fakti i mosndëshkimit të autorëve. Më pak se 10 për qind e rasteve të regjistruara të shkeljeve të të drejtave të gazetarëve që janë në Regjistrin e sulmeve të SHGM-së në pesë vitet e fundit presin vendim gjyqësor.

*Për sulmin me sëpatë ndaj gazetarit Nevri Ademi nga Gostivari, i cili ka ndodhur më 16 shkurt të vitit 2022, tani më ka vendim gjyqësor. Gjykata Themelore në Gostivar solli aktgjykim për fajtor dhe dënim me kusht prej tre muajsh burg për sulmuesin.*

SHGM gjatë vitit 2022, në takimet me Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe në reagimet publike, insiston vazhdimisht për hetime më të shpejta dhe më efektive të sulmeve ndaj gazetarëve si dhe në përmirësimin e kushteve të punës së gazetarëve dhe punonjësve të medias kur ata raportojnë nga hapësirat e këtij institucioni.

Pas indikacioneve të SHGM-së për nevojën e regjistrimit të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias, Ministria e Punëve të Brendshme filloi të mbajë evidencë për sulmet, e cila nuk është në dispozicion për publikun, por me kërkesë të SHGM-së ajo dërgohet për nevojat e brendshme të zyrës së Shoqatës. SHGM dhe Avokati i Popullit në maj të vitit 2019 nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi përmes të cilit të dyja institucionet u angazhuan që në të ardhmen të punojnë në mënyrë aktive në temat që kanë të bëjnë me sigurinë e gazetarëve. Pavarësisht këtij memorandumit, nuk janë zhvilluar aktivitete konkrete mes SHGM-së dhe AP-së në vitin 2022 dhe të drejtat e gazetarëve si dhe e drejta e lirisë së shprehjes nuk janë pjesë e raportit vjetor të të drejtave të njeriut të këtij institucioni.

Sulmet ndaj gazetarëve janë të shënuara edhe në raportet ndërkombëtare, në të cilat matet niveli i demokracisë dhe lirisë së shprehjes në Maqedoni. Në raportin e Komisionit Evropian për progresin e vendit për vitin 2021 thuhet se Ministria e Punëve të Brendshme ka regjistruar tetë raste të sulmeve ndaj gazetarëve ndërsa dhjetë në vitin 2020. Komisioni Evropian thekson se korniza ekzistuese ligjore dhe përkushtimi ndaj standardeve ndërkombëtare ofrojnë mekanizma të mjaftueshëm që institucionet të ndëshkojnë autorët, e njëjta gjë nuk është e dukshme në terren dhe vërehet procedurë jo mjaftueshëm e shpejtë dhe efektive. Komisioni Evropian arrin në përfundim se politikanët në të gjitha nivelet e qeverisjes së tyre dhe zyrtarët publikë duhet të japin vazhdimisht shembuj për standarde të larta për respektimin e lirisë së mediave në ndërveprimet e tyre me gazetarët.

**A ofron shteti trajnime adekuate për policinë, prokurorët, avokatët dhe gjyqtarët në lidhje me mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe gazetarëve? A i organizojnë këto trajnime në bashkëpunim me shoqatat e gazetarëve?**

Shoqata në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta organizoi seminarin me temë "Përmirësimi i bashkëpunimit mes gaze-



tarëve dhe organeve policore me synim për përgjegjshmëri dhe transparencë më të madhe”, ku morën pjesë gazetarë si dhe përfaqësues të Ministrisë të Punëve të Brendshme të cilët punojnë në fushën e marrëdhënieve me publikun. Qëllimi i aktivitetit ishte thellimi i bashkëpunimit ndërmjet gazetarëve, anëtarëve të MPB-së dhe aktorëve të tjerë mediatik në shkëmbimin e informacioneve të karakterit publik. Përfundimet që dolën nga ngjarja ishin se përdorimi i buletinit të policisë, i cili përmban informacione të nevojshme bazë për informimin e publikut është i një rëndësie thelbësore. Mirëpo nëse gazetari ka nevojë për informacione më të detajuara, në atë rast shërbimet e MPB-së në kuadër të mundësive të tyre do ta sigurojnë informacionin. Në këtë ngjarje u prezantua edhe publikimi i titulluar “Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet gazetarëve dhe autoriteteve policore me qëllim të llogaridhënies

dhe transparencës më të madhe”<sup>68</sup>. Në kuadër të bashkëpunimit të mirë dhe shkëmbimit të përvojave nga SHGM u botua studimi i titulluar “Qëndrimet dhe perceptimet e gazetarëve për transparencën e gjyqësorit në Maqedoninë e Veriut”<sup>69</sup>, i cili u promovua në shtator të vitit 2022 në Gjykatën Penale në Shkup. Ky aktivitet nxiti një diskutim mes palëve të interesuara si dhe shpresën e dëshirën që në të ardhmen të krijohet një bashkëpunim më i thellë si dhe të zgjidhen problemet dhe pengesat e vazhdueshme në rrugën që e vështirësojnë procesin e punës së gazetarëve, nga njëra anë, si dhe prokurorëve dhe gjyqtarëve nga ana tjetër.

68 Ibid.

69 SHGM, “Drejtesia transparente për gazetarët profesionistë”, 29.9.2022, Qasur më 18.12.2022. <https://bit.ly/3HQERVB>

Tabela 3. Pasqyrë e rasteve më të rënda të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve në 5 vitet e fundit

Viti	Rast 2018	2019	2020	2021	2022
<b>Ekipi gazetaresk i MIA-së</b> Sulm ndaj ekipit gazetaresk gjatë raportimit nga protesta dhe tentativë për konfiskimin e pajisjeve				Tentativë për kapjen e pajisjeve dhe shtytje, gjatë së cilës kameramani është shtyrë dhe pajisjet e tij janë dëmtuar. Sulmi është kryer nga qytetarët. Për sulmin është dorëzuar raport në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe nuk ka zgjidhje.	MPB-ja nuk ka dhënë asnjë informacion për sulmuesit në mënyrë që PTHP Shkup të mund të ndërhyjë penalisht.
<b>Ekipet e gazetarëve të mediave</b> Pa censurë, TV 21, Gazeta ekspres, Tetova Sot, Koha TV, Koha News, Kumanova sot, TV Shenja dhe Lajmi Press.				Kërcënime për jetë dhe sulm ndaj mediave dhe kërcënime ndaj gazetarëve. Rasti është raportuar në MPB, e cila ka dërguar njoftim në SHGM se ndaj personit është ngritur kallëzim penal dhe presin që Prokuroria Publike të veproj në bazë të raportit.	Është bërë kallëzim penal, trajtohet në kuadër të procedurës para hetimore për verifikimin e pretendimeve
<b>Ekipi gazetaresk i TV 21</b> Pas raportit televiziv të regjistruar për ankesat e banorëve të Komunës së Haraçinës për infrastrukturën e dobët, familjarët e kryetares së komunës Milikije Halimi kanë dërguar kërcënime verbale se do t'i thyejnë kamerën dhe kanë kërkuar që të fshihen regjistrimet.			Rasti nuk është raportuar në polici, por SHGM në disa raste ka thirrur policinë dhe Prokurorinë Publike për të hapur hetime. Megjithatë, Prokuroria vendosi të mos veprojë në bazë të informacionit.		Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për ta kërkuar në sistem

Viti	Rast 2018	2019	2020	2021	2022
<b>Naser Selmani</b> Gazetari dhe kryetari i atëhershëm i SHGM-së ka marrë mesazh me kërcënime për vdekje nga Beitulla Asani, vëllai i Bekir Asanit, i cili është i lidhur me partinë politike në pushtet BDI.	Rasti është denoncuar në polici, ndërsa prokuroria ka nisur hetimet. Deri më tani janë thirrur për të dëshmuar edhe Naser Selmani edhe kërcënuesi.	Rasti është në proces në Prokurorinë Themelore Publike.			Janë marrë në pyetje Beitulla Asani dhe Naser Selmanidhe është lëshuar kërkesë për dërgimin e dërgimin e të dhënave tjera nga rrjeti social Facebook.
<b>Armand Braho</b> Dhunuesit nga radhët e partisë Aleanca për Shqiptarët sulmuan gazetarin Armand Braho gjatë një konference për shtyp ku ai ishte i ftuar.	Rasti është raportuar në polici. Gjykata i gjobiti sulmuesit.				Në të dhënat elektronike të Prokurorisë Publike nuk ekziston si ngjarje e evidentuar.
<b>Grupi i gazetarëve</b> Disa gazetarë dhe punonjës të medias u sulmuan nga turma që hyri me forcë në Parlament më 27.04.2017.	Prokuroria ndjek penalisht personat që sulmuan politikanët, por nuk ndjek penalisht ata që sulmuan gazetarët dhe punonjësit e medias.	Avokatët e SHGM përfaqësojnë 7 gazetarë dhe në emër të tyre do të ngrënë 4 padi, 3 prej të cilave janë individuale dhe një padi është në grup për tre gazetarë.		Avokatët e SHGM-së janë në pritje të aktgjykimit të shkallës së dytë nga Gjykata Penale në mënyrë që procedura civile të vazhdojë.	Në të dhënat elektronike të Prokurorisë Themelore Publike-Shkup nuk ekziston ngjarje e regjistruar, as informacione që autori/ët janë identifikuar
<b>Vladimir Zhelçeski dhe Aleksandar Todorov</b> Dy gazetarët, të cilët raportojnë për protestën e madhe "Për Maqedoni të përbashkët", janë sulmuar fizikisht nga persona të panjohur – pjesëmarrës në protestë, pasi nuk i përkasin mediave pro-qeveritare. Ata janë goditur disa herë, nga të cilat kanë pësuar lëndime fizike dhe më pas janë mbajtur në spital për 24 orë.	Gjykata i dënoi sulmuesit me 6 muaj burg.				PROPOZIM I AKUZËS propozim për vepër penale - Dhunë nga neni 386 paragrafi 3 vv. paragrafi 1 nga Kodi Penal. GJYKIMI i Gjykatës Penale nr.631/18 e datës 7.9.2018, me të cilën është dënuar me 6 muaj burg. Aktgjykimi u vërtetua me aktgjykim të Gjykatës së Apelit Shkup GjD Nr.10/19 datë 06.02.2019
<b>Meri Jordanovska</b> Emil Jakimovski ka dërguar kërcënime dhe ofendime ndaj gazetares dhe zëvendës/redaktorit të portalitA1on, Meri Jordanovska. Sipas mesazheve të publikuara nga Jordanovska, kërcënuesi e ka ofenduar me fjalë nënçmuese duke e kërcënuar se do ta "krijojë në nekrologji".			Propozim aktakuzë për veprën penale të rrezikimit të sigurisë, për mesazhet kërcënuese të dërguara përmes rrjetit social Telegram. Aktgjykimi K. nr. 212/20 i datës 16.3.2020, me të cilin është dënuar me 1 vit e 8 muaj burg. Kundër aktgjykimit është parashtruar ankesë, por ankesa është refuzuar dhe aktgjykimi është vërtetuar me shkallë të dytë nga gjykata.		PROPOZIM I AKUZËS propozim për vepër penale - Dhunë nga neni 386 paragrafi 3 c.c paragrafi 1 nga Kodi Penal. GJYKIMI i Gjykatës Penale K. nr.631/18, datë 07.09.2018, me të cilën është dënuar me 6 burg muaj. Aktgjykimi është vërtetuar nga Gjykata e Apelit Shkup Nr.10/19 datë 06.02.2019.

# Konkluzionet and Rekomandime

## KONKLUZIONET

Kah fundi i vitit 2022, ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për Përgjegjësinë Civile për Shpifje dhe Fyerje u votuan nga ana e deputetëve në Kuvend. Faza tjetër është të vendoset si pikë në rendin e ditës të seancës plenare dhe të votohet nga deputetët. Ndryshimet në Kodin Penal, në aspekt të mbrojtjes më të madhe të gazetarëve dhe punonjësve të mediave nuk ndodhën as në vitin 2022 ndonëse Ministria e Drejtësisë njoftoi se po përgatitet një projektligj i ri i cili duhet t'i dërgohet Qeverisë për ta shqyrtuar në procedurë të mëtejshme që të vendoset në procedurë parlamentare para deputetëve në Parlament. Pavarësisht shpalljes për Kod të ri Penal, amendamentet që garantojnë mbrojtje më të madhe për gazetarët janë paralajmëruar të miratohen gjatë vitit 2023.

Është me rëndësi të theksohet se pas insistimit disavjeçarë të SHGM-së, në tetor të vitit 2022 Prokuroria Themelore Publike Shkup, emëroi Iskra Haxhi Vasileva, Prokuroren Publike nga i njëjti institucion, si person kontaktues në lidhje me rastet që kanë të bëjnë me sigurinë e gazetarëve, e të cilët janë në kompetencë të Prokurorisë Themelore Publike Shkup.

Çështje shqetësuese nga aspekti i mbrojtjes së pluralizmit politik është reklamimi politik me pagesë, i cili nuk ndalohet në mënyrë eksplicite gjatë periudhës jashtë zgjedhore ndërsa gjatë kohës së fushatave zgjedhore mbulohet me mjetet e buxhetit të shtetit.

Qëndrimi i SHGM-së është se reklamimi politik me pagesë në media duhet të hiqet në çdo kohë sepse në këtë mënyrë “blihen” pronarët e mediave dhe kjo praktikë ndikon negativisht në politikën redaktuese të mediave dhe “zhvendos” balancimin e pikëpamjeve të kundërta në sferën publike. SHGM ishte kundër ndryshimeve të mundshme të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale, i cili do të lejonte reklamimin e institucioneve publike në mediat audiovizuale. SHGM insiston në mënyrë konstruktive për krijimin e një Fondi për Media të Lira, përmes të cilit do të mbështeten projekte me interes publik për produkte të gazetarisë dhe përmes të cilit do të mundësohet financimi i projekteve për gazetari hulumtuese, analitike, dokumentare, edukative dhe arsimore. Në këtë mënyrë praktikisht do të ndihmohet gazetaria dhe do të ndikohet edhe në përmirësimin e të ardhurave të gazetarëve dhe punëtorëve të mediave. Kjo do të shmanget kthimin e industrisë së medias në gjendjen e nivelit ku ishte pesë vite më parë, kur pa kriterë, me fonde shtetërore paguheshin mediat në mënyrë jo transparente me shuma astronomike. Reformat në servis publik pothuajse nuk kanë filluar dhe pavarësia financiare si dhe qëndrueshmëria e servisit publik mbetet një pyetje e hapur ndërsa RTM në vitin 2022 shënon një buxhet edhe më të vogël në krahasim me vitet e kaluara.

Vlerësimi i përgjithshëm është se pozita socio-ekonomike e gazetarëve nuk u përmirësua dukshëm në vitin 2022, krahasuar me vitet e kaluara kur ndikim të madh kishte pandemia dhe kriza shëndetësore, gjegjësisht për shkak të uljes së të ardhurave nga reklamat në gjithë sektorin mediatik edhe pse në media të caktuara ka rritje minimale të të ardhurave mujore të punëtorëve. Statusi i punës së shumë gazetarëve, veçanërisht në mediat private është i pasigurtë sepse gazetarët kryesisht kanë kontrata me afat të caktuar ose honorare, disave nuk u paguhën pensionet dhe sigurimet sociale, kanë të ardhura të ulëta dhe nuk i respektohen edhe të drejta tjera të punës. Për këtë shkak gazetarët janë shumë më të ndjeshëm ndaj presioneve nga strukturat drejtuese, pronarëve dhe politikanëve.

Presionet janë kryesisht të fshehura dhe pak të dukshme, gazetarët përmbahen të flasin hapur për këto dukuri dhe rrallë raportojnë kur u shkelen të drejtat themelore. Edhe pse vlerësohet se gazetarët në redaksi në përgjithësi kanë më shumë liri, përsëri ka shumë ndikime në punën e përditshme, të cilat nuk janë edhe aq të dukshme, ka më shumë autocensurë sesa presione të drejtpërdrejta. Më e keqe është pozita e gazetarëve në mediat lokale dhe rajonale, për faktin se këto media janë në gjendje të keqe financiare, e përveç kësaj, pushtetarët vendas në zonat e vogla mund të ushtrojnë më lehtë presion ndaj tyre. Statusi i punës dhe pozicioni i gazetarëve në redaksi nuk ndryshon shumë nga ai i kolegëve të tyre gazetarë, me përjashtim të faktit se ka më pak gra në poste drejtuese në media.

Në vitin 2022 numri i sulmeve ndaj gazetarëve shënoi rritje. Megjithatë edhe pse numri i kërcënimeve verbale dhe fizike në përgjithësi është në rënie krahasuar me 10 vitet e fundit, shqetësues është fakti që gazetarët dhe profesionistët e mediave janë gjithnjë e më shumë subjekt i kërcënimeve dhe ngacmimeve në rrjetet sociale, disa prej të cilave ishin kërcënime serioze për sigurinë fizike të gazetarëve të cilët punojnë në hulumtimin e korrupsionit dhe dukurive tjera negative sociale. Me rëndësi mbetet të theksohet se në dhjetor të vitit 2021 u shqiptua një vendim gjyqësor në favor të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) për një kërcënim në internet ndaj të gjithë gazetarëve, e shkruar në faqen e SHGM-së në Facebook. Ky është shembulli i parë i Prokurorisë dhe Gjykatës që hetojnë dhe sanksionojnë një kërcënim serioz në internet të drejtuar ndaj gazetarëve. Një shembull tjetër që hodhi dritë pozitive është hetimi i shpejtë i cili përfundoi me vendim gjyqësor për sulmin e muajit shkurti ndaj Nevri Ademit nga Tetova, por ky është vetëm një shembull pozitiv që mund të theksohet. Problem i madh vazhdon të mbetet ende mosndëshkimi sepse institucionet kompetente nuk bashkëpunojnë sa duhet dhe rrallëherë ngritin aktakuza kundër autorëve të kërcënimeve apo sulmeve, ndërsa në rastet kur inicohen hetime ato zhvillohen ngadalë dhe në mënyrë joefikase. Në veçanti shqetësuese është gjuha e urrejtjes dhe etiketimi i gazetarëve dhe punëtorëve të mediave nga politikanët dhe bartësit e funksioneve të tjera publike si dhe trendi i dyfishimit të numrit të padive për shpifje dhe fyerje në krahasim me vitin e kaluar. Krahas kësaj, institucionet kompetente dhe gjykatat ende nuk mbajnë shënime të përditësuara sa duhet për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve dhe as nuk i publikojnë të dhënat e tilla. Megjithatë pozitive është që institucionet kompetente janë të hapura për bashkëpunim me SHGM-në dhe përmes konsultimeve të përbashkëta tregojnë gatishmëri për të punuar në përmirësimin e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve të mediave duke marrë masa më të shpejta dhe duke ndjekur penalisht autorët e sulmeve dhe kërcënimeve.

## REKOMANDIME

Ndërhyrjet ligjore dhe përmirësimi i zbatimit të ligjeve:

- Zbatimi i procedurës së përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të ASHAAM dhe Këshillit Programor të RMT-së nga Kuvendi i RMV-së. Procedura duhet të kryhet në mënyrë transparente, me dëgjim publik të të gjithë kandidatëve, duke ruajtur parimin e shumicës së dy të tretave të votave në procesin e vendimmarrjes së Kuvendit. Nevojitet një analizë e dispozitave të Ligjit për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale dhe lig-

jeve të tjera përkatëse në drejtim të përmirësimit të gjendjes financiare të mediave private dhe vendosjes së mekanizmave për lehtësim tatimor dhe përfitim të ngjashme për mediat.

- Nevojitet urgjentisht të hapet debat për krijimin e mundshëm të një Fondi për mediat, veçanërisht për qëllimet dhe kriteret e mbështetjes financiare (nxitja e diversitetit programor, përmirësimi i statusit të gazetarëve, etj.), mënyra e shpërndarjes së fondëve, pavarësia dhe objektiviteti në zbatimin e procedurës.
- Nevojiten ndryshime dhe plotësime në Kodin Zgjedhor, të cilat do të thjeshtojnë rregullat për fushatën mediatike dhe do të ulin mundësinë e abuzimit me reklamën politike me pagesë në mediat private.
- Inicimi i ndryshimeve dhe plotësimeve në Kodin Etik të Gazetarët në servis publik të RTM-së për të fokusuar vetë-rregullimin e brendshëm në këtë medium.

Përforsimi i sigurisë së gazetarëve:

- Votimi në Kuvend i ndryshimeve dhe plotësimeve në Kodin Penal në dy drejtime: 1) Ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave që përcaktojnë gjuhën e urrëjtjes në përputhje me praktikën e GJEDNJ, dhe 2) Ndryshimi dhe plotësimi në pjesën e kompetencave të PTHP-së për kryerjen e detyrës zyrtare në rast të sulmit ndaj gazetarit dhe/ose punonjësit të medias, si dhe parashikimi i dënimeve më të larta për shkelësit e ligjit.
- Krijimi i regjistrave të posaçëm për çështjet e padive kundër gazetarëve, pranë gjykatave themelore civile dhe penale, përfshirë edhe PTHP-në.

- Zbatimi efikas i ligjeve për siguri më të mirë të gazetarëve dhe punonjësve të mediave.
- Proces i vazhdueshëm në ngritjen e kapaciteteve të gazetarëve, avokatëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve për temat që kanë të bëjnë me sanksionimin e sulmeve ndaj gazetarëve dhe interpretimin e përgjithshëm të nenit 10 të GJEDNJ.
- Përmirësimi i bashkëpunimit me përfaqësuesit e sapozgjedhur të Kuvendit të RMV-së për temat që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes dhe politikën e mediave.
- Vazhdimi i lobimit të SHGM-së për futjen e protokolleve dhe përmirësimin e procedurave të brendshme në institucione, me qëllim parandalimin e dhunës ndaj gazetarëve dhe sanksionimin efektiv të saj.
- Me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup, të përmirësohet bashkëpunimi me Avokatin e Popullit.

Përmirësimi i të drejtave të punës së gazetarëve:

- Vazhdimi i përpjekjeve të SPGPM-së, me mbështetjen e SHGM-së, për nënshkrimin e kontratave të reja kolektive me mediat private.
- Realizimi i fushatave dhe trajnimeve, përmes të cilave gazetarët dhe mediat do të njiheshin më shumë me të drejtat e tyre elementare të punës.
- Të vazhdojë siguri i asistencës juridike dhe shërbimeve këshillimore për gazetarët dhe punonjësit e mediave nga shoqatat esnave të gazetarëve.
- Intensifikimi i bashkëpunimit dhe dialogut me institucionet në interes të mbrojtjes së të drejtave të punës së gazetarëve dhe punonjësve mediatik.





